# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7642 E mërkurë 5 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)









Opinioni i Ditës

Nga PËRPARIM KABO

## Qyteti dhe siguria...!

Çfarë do të thotë një qytet i sigurt?! Një qytet që ka të garantuar jetën dhe sigurinë e pronës do të ishte përgjigjja e parë dhe ndoshta e gjithëpranuara ...

Vijon në faqet 20-21





Kritika e Ditës

Nga JOSIF PAPAGJONI

## Shfaqja që ndaloi Stalini, tallje e strukturave sociale

Në sy të parë duket sikur tallesh me njeriun e rëndomtë, të dështuar, mjeran, por tutje këtij veli tallja është më e thellë, e pamëshirshme, duke luajtur ...

Vijon në faqen 19



Kreu i Kuvendit: “Teatri”? S’ka shtyrje

## Ruçi: Nuk këshilloj djegie mandatesh. Basha: Çlirojmë vendin nga krimi

Kreu i PD në Shkodër: Të evidentojmë figurat më të mira për zgjedhjet e ardhshme

Nga DARINA TANUSHI

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi deklaroi dje në një bashkëbisedim me gazetarët se opozitës i janë krijuar të gjitha kushtet për të marrë pjesë në Kuvend, ndërsa i bëri thirrje që të bashkohet për të nisur sesionin me etikë ...

Në faqet 2-3

MINISTRI I FINANCAVE: DO SHPERNDAHEN 3 MILIARDE LEKE PER 610 MIJE VETA

# PENSIONISTET, AHMETAJ: SA SHPERBLIM DO MARRE SECILI

Ndryshon buxheti 2018, shkurtohen fondet për vetingun, Erjon Braçe kundër. Jorida Tabaku: Në Shqipëri 33 biznese mbyllen çdo ditë



*(Në foto)* Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

Në faqen 5

NGJARJA

## Pronari i lokalit në Laç kërcënoi gazetarin, policia: Rasti i kalon prokurorisë

Në faqen 8

40 VENDE BOSH

## Arben Gjata: 220 regjistrime në Mjekësinë e Përgjithshme

Në faqen 11

KOSOVE

## Haradinaj paraqet në Kuvend negociatorët e dialogut me Serbinë

Në faqen 12

ARSIMI I LARTE



## Universiteti i Durrësit, rektorja: Kemi plotësuar 50% të kuotave

Në faqen 10

Ndërtimet pa leje, lista e familjeve që marrin tapitë në zonat informale

# ALUIZNI: 950 personat që do të marrin lejet

*Përfituesit nga procesi i legalizimit në qarkun e Shkodrës*

Nga ORNELA MANJANI

ALUIZNI publikon listën me 950 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Shkodrës. Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër bën të ditur se qytetarët që gjejnë emrin në listë të paraqiten pranë kësaj drejtorie për të tërhequr lejen e legalizimit, në rast të mosparaqitjes së tyre brenda një jave, leja do të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën ...



Në faqet 6-7

"SUMMER PAGES"

## Anjeza Branka: Shqiptarët janë të përmalluar, mezi na presin në skenë

Suplement

# SITUATA POLITIKE

## PERPLASJA

Kreu i PD-së paralajmëron përshkallëzim të aksionit radikal politik të opozitës

# Basha garanton shqiptarët: Bashkë do çlirojmë qeverisjen nga krimi

*"Nuk ka rrugë tjetër veç përballjes"*



Valentina Madani

PD-ja nisi dje nga Shkodra mobilizimin e strukturave për reagim të ashpër qytetar kundër qeverisë dhe lidhjeve të saj me krimin. Kreu i opozitës ishte dje sërish në kryeqendrën e veriut nga ku paralajmëroi përshkallëzim të aksionit politik të opozitës, një ditë pasi refuzoi çdo ftesë për bashkëpunim me mazhorancën. Basha kërkoi angazhim maksimal nga strukturat drejtuese të Partisë Demokratike në këtë qytet gjatë një takimi që zhvilloi me kryesinë e degës. Sipas tij gjithçka do të jetë në funksion të çlirimit të qeverisë nga krimi. Lulzim Basha foli për përballje të opozitës me qeverinë dhe kjo sipas tij vjen nga lidhja e qeverisë me krimin dhe asgjësimin e institucioneve. "Ajo që ka rëndësi, është shkalla e mobilizimit me të cilën ne si PD, në nivelin e lagjeve, blloqeve, shtëpive e fshatrave, do të mund t'i përgjigjemi thirrjes për një aksion radikal politik, që të ketë synim largimin e këtij kryeministri dhe të kësaj qeverie. Që nga ky moment, që kur të ndahemi prej këtij takimi, puna duhet të nisë derë me derë me njerëzit. Sot rrugë tjetër përveç përballjes nuk ka",-theksoi z.Basha. Në funksion të kësaj sfide, Basha tha se procesi i organizimit të brendshëm në Partinë Demokratike duhet të evidentojë figurat më të mira për zgjedhjet e ardhshme lokale dhe ato parlamentare që janë objektiv final i aksionit dhe platformës që opozita pritet ta bëjë publike ditët në vijim. Mes të tjerash ai theksoi se zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë objektivi final i aksionit dhe i platformës, që opozita do të bëjë publike në ditët dhe javët e ardhshme. Gjatë takimit me kryesinë e degës së Shkodrës z.Basha i kërkoi përfaqësuesve të PD që të përdorin avantazhin kryesor të opozitës për të mobilizuar njerëzit. Lideri i demokratëve ftoi qytetarët që t'i përgjigjen thirrjes për aksion radikal politik. "Prandaj ka shumë rëndësi që procesi i organizimit të brendshëm, të evidentojë më të mirët brenda partisë, të evidentojë më të mirët në raport me zgjedhjet e ardhshme lokale dhe me gjasa zgjedhjet e ardhshme parlamentare, që janë objektivi final i aksionit dhe i platformës, që opozita do të bëjë publike në ditët dhe javët e ardhshme"- deklaroi kreu i PD-së. Më herët kreu i opozitës përcolli një mesazh të fortë për shqiptarët, të cilët i garantoi se opozita do të jetë në krah të tyre në përballje me bandat. "Partia Demokratike dhe opozita do vazhdojnë të jenë në krah të qytetarëve në përballje me bandat në Shkodër, Elbasan, Durrës, Vlorë apo kudo ku ato qofshin! Bashkë do çlirojmë qeverisjen dhe vendin nga krimi! PA KOMPROMIS!",-shprehet z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Shkodër

**ZGJEDHJET**

"Prandaj ka shumë rëndësi që procesi i organizimit të brendshëm të evidentojë më të mirët brenda partisë, të evidentojë më të mirët në raport me zgjedhjet e ardhshme lokale dhe me gjasa zgjedhjet parlamentare, që janë objektivi final i aksionit dhe i platformës, që opozita do të bëjë publike në ditët dhe javët e ardhshme." - tha z.Basha.

**"Blinda dhe mitraloza, kriminelët drejtojnë policinë"**

# Berisha: Rama drejton bandat në Shkodër, terror si në '97 në Tropojë

Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po përdor një skenar kriminal në Shkodër përmes bandave të tij duke krijuar një terror të ngjashëm si rastin e Tropojës në vitin 1997. Z.Berisha publikoi mesazhet e dy qytetarëve dixhitalë, të cilët denoncojnë situatën në Shkodër. "Terrori i narkobandave në Shkodër është i lidhur me Norigen! Policia nga Tirana në Shkodër për teatër! Lexoni mesazhet e qytetarëve dixhital. Ky terror në Shkodër është i organizuar nga qeveria njëlloj si terrori i vitit 1997 në Tropojë. Bandat e Shkodrës varen direkt nga kryeministri Rama urdhërojnë dhe bëjnë ligjin në drejtorinë e policisë si dhe kanë në postet më të rëndësishme të saja njerëzit e vet që prishin çdo provë të vrasjeve seriale, prandaj askush nuk arrestohet. Në Dobraç banda e Bajreve disponon blinde mitroloza dhe të gjitha mjetet e tjera, nuk guxon kush me shkel aty. Forcat që erdhën dje nga Tirana vetëm sa bënë demonstrim në qytet, por nuk shkelen, nuk u afruan në zonat e tetë bandave që sundojnë qytetin. Doktor, duhet zgjidhje". "Doktor unë që po të shkruaj jam me adresë false dhe jam nga Shkodra. Ne lidhje me ngjarjet kriminale në Shkodër si ka mundësi që vijnë 10 furgona. Policët në 10 të natës edhe RENEA e FNSH në aksion dhe prapë se prapë nuk ka as arrestime e asgjë.. i bëj thirrje drejtorit të policisë Ardi Veliu mos hajde të hash darka qyl. Në lokalet e Shkodrës, por jep rezultate se nesër pasnesër e kemi radhën në të pafajshmit me gjoba, kërcënime dhe shantazhe. Reagoni se situata sa është nxeh në Shkodër",-thuhet në denoncimet në adresë të z.Berisha.



# "Teatri", Salianji: Nëse shkelet vija e kuqe, vendi shkon në revolta

Një ditë pas mbledhjes së përbashkët të deputetëve të opozitës në qytetin e Shkodrës, deputeti i PD-së Ervin Salianji, zbardhi aksionin që do pasojë këtë takim. Në emisionin "Top Talk" në Tch, deputeti demokrat vuri theksin tek çështja e "Teatrit". I pyetur nga gazetari Denis Dyrnjaja se "çfarë do të bëjë opozita nëse do të shkelej vija e kuqe në lidhje me çështjen e teatrit", (ashtu siç e kanë quajtur ata), Salianji tha se vendi mund të shkojë edhe në revolta. "Nuk bëhet fjalë vetëm për shembjen e Teatrit Kombëtar. Ne jemi për ruajtjen e godinës. Por problemi është se PS me ligjin "Fusha" do të vjedhë miliona euro. Filtrin e Presidentit të Republikës e rrëzuan. Gjykata Kushtetuese mungon. Nëse shkelet vija e kuqe, atëherë qytetarët nuk do të lejojnë dhe do të dalin në ballë në qytetarëve dhe mund të ketë edhe një konflikt civil",-tha Salianji.



# Nishani: Krimi i organizuar, partner politik i qeverisë

Ish-presidenti Bujar Nishani shpreh shqetësimin se tashmë krimi është bërë partner i politikës së qeverisjes së majtë në vend. Po ashtu ai ka nënvizuar faktin se vetëm populli sfidon krimin politik. "Krimi i organizuar tashmë partner politik i qeverisjes të së majtës.

Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Dibra, Vlora nën kontrollin e grupeve kriminale, vrasësve, grabitësve, gjobëvënësve, të droguarve.

Kërcënim për çdo familje, çdo qytetar, çdo fëmijë.

#vetëmpopullisfidonkriminpolitik",-shkruan Nishani.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafile VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk





## Vasili: Maxhorancës nuk ia mban të votojë dekretin për Teatrin

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së u bën thirrje qytetarëve të refuzojnë pagesën e Rrugës së Kombit, e cila pritet të aplikohet nga 17 shtatori. Përmes një postimi në "Facebook", Vasili e quan "vjedhje të turpshme" këtë taksë: "Qytetarët paguajnë qindra milionë euro për rrugët, ndaj dhe karburantin e kanë shqepur me taksa dhe është me çmimin më të tmerrshëm në Europë krahasuar me pagat e mjerueshme të shqiptarëve. Qytetarë, refuzojeni pagesën e Rrugës së Kombit se është vjedhje e turpshme", shkruan Vasili. Ndërkohë në një intervistë televizive për "Report TV", kryetari i grupit të LSI, Petrit Vasili foli edhe për aksionin e opozitës në sesionin e ri parlamentar që nisi me një mbledhje nga Shkodra. Vasili u shpreh se do të ketë përballje frontale me qeverinë dhe protesta. "Shqipëria ka mundësi që të mposhtë kriminelët në pak kohë. Kriminelët janë motivuar se një pjesë e tyre ndodhen në qeveri. Në Shkodër ka një sistem gjobëvënie të përjavshëm", tha ai. Përsa i përket ligjit të Teatrit, Vasili sfidoi shumicën duke u shprehur se nuk ia mban që ta rrëzojë dekretin e presidentit që riktheu ligjin për rishqyrtim në Kuvend, ndërsa e paralajmëroi se nëse e ndërmerr një nismë të tillë do të përballet me një qëndresë të fortë që do mbetet gjatë në memorie.

"Teatri", kreu i Kuvendit: Nuk ka shtyrje të dekretit, do konsultohemi

# Ruçi, opozitës: Mandatet nuk janë djegur ndonjëherë, por s'ua këshilloj

## "Kriminaliteti, i gjithë parlamenti të shkonte në Shkodër"

Darina Tanushi



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

**THIRRJA**
"Nga çelja e negociatave nuk fiton as qeveria, as opozita, por Shqipëria. Por që të fitojmë të gjithë, duhet të kontribuojmë të gjithë. Të unifikojmë qëndrimet me Brukselin si një ushtrim për të unifikuar qëndrimet me të gjithë faktorët ndërkombëtarë", tha Ruçi, duke iu drejtuar opozitës.

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi deklaroi dje në një bashkëbisedim me gazetarët se opozitës i janë krijuar të gjitha kushtet për të marrë pjesë në Kuvend, ndërsa i bëri thirrje që të bashkohet për të nisur sesionin me etikë parlamentare. Nisur nga deklaratat e kreut të Partisë Demokratike dhe mundësinë e djegies së mandateve nga opozita, Ruçi u shpreh se parlamenti është zgjedhur nga sovrani dhe kush ka vlerësime të veçanta për individë të veçantë duhet t'i adresojë në institucionet përkatëse. "Refuzoj të komentoj deklaratat politike si të maxhorancës dhe të minorancës. Megjithatë, nuk mund të qëndroj jashtë këtyre deklarimeve. Jam këtu për të bërë detyrën e kryetarit të Kuvendit. Kuvendi nuk mund të konsiderohet fole kriminelësh, atë e ka sjellë sovrani aty sipas Kushtetutës e ligjeve. Kush ka vlerësime të veçanta për individë të veçantë, ka institucionet përkatëse. Kuvendi mbetet Kuvend dhe mbështet interesat e vendit", tha Ruçi. Sa i përket djegies së mandateve, Ruçi tha se nuk ka dijeni, por se nuk e këshillon, duke e konsideruar më efikas diskutimin brenda sistemit. "Për sa i përket djegies së mandatave, nuk e kam dëgjuar; kam dëgjuar marrëdhënie të kushtëzuar, zëra të veçantë para këtij sesioni ka qenë djegia e mandatave. Më falni për mungesën e modestisë, falë eksperiencës i kam provuar të dyja, luftën politike brenda dhe jashtë sistemit. Nuk janë djegur ndonjëherë mandatet, megjithatë ka gjithmonë një herë të parë, por nuk e këshilloj. Kushtëzimi, apo termi që djegim mandatin kanë qenë të diskutuara edhe nga opozita e dikurshme, por më rezulton se më efikas është diskutimi brenda sistemit", deklaroi Ruçi. "Lidhur me kriminalitetin, kam dëgjuar se përdoret shumë në retorikën politike dhe në luftën politike. Pikërisht lufta kundër kriminalitetit duhet të bashkojë faktorët politikë dhe jo t'i ndajë ata, të cilët e luftojnë dhe ata që e mbrojnë krimin. Për mua, krimi nuk ka ngjyrë dhe kur ai të merr, nuk të pyet as për kë voton dhe as kujt subjekti politik i përket, por të merr jetën për interesa të veta. Kështu që, në qoftë se thashë se ka plot gjëra që na bashkojnë, një nga ato është lufta kundër krimit. Unë do të isha shumë i ndjerë dhe shumë i lumtur në qoftë se ai gjest që bëri dje opozita në Shkodër të mos bëhej në mënyrë të njëanshme, por ta merrte iniciativën opozita dhe i gjithë parlamenti shqiptar të shkonte në Shkodër, të gjithë deputetët me mua në krye, në mbështetje të të dëmtuarve dhe në rritjen e opinionit publik ndaj krimit dhe kriminelëve", deklaroi Ruçi. Sipas tij, "sa më shumë të ndahen forcat politike, opinionet politike apo të shoqërisë dhe sa më pak të jetë unik qëndrimi i shoqërisë dhe i politikës për krimin, aq më shumë gjallërohet krimi dhe kriminaliteti. Kështu që unë do të mbështesja çdo nismë ligjore që forcon legjislacionin shqiptar, jo për të eliminuar krimin, sepse siç e thashë, do të ishte lumturi e madhe për njerëzimin kur të vijë ajo ditë që të mos ketë më krim, por për të zvogëluar dhe minimizuar atë, ashtu siç do të mbështesja çdo iniciativë që do të bashkonte qëndrimet politike për të përballuar krimin".

**NEGOCIATAT**

**QEVERIA**
"Për sa u përket ndryshimeve në qeveri, kjo nuk është detyra ime. Unë si kryetar i Kuvendit do t'i mirëprisja të gjitha instrumentet parlamentare: seancat e pyetjeve, seancat e interpelancave, mocionet pa debat, mocionet e besimit apo të mosbesimit", u shpreh dje Ruçi.

Sipas Ruçit, "ky sesion dhe ai i pranverës 2019 do të kenë si mision kurorëzimin e hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor 2019". Kreu i Kuvendit vlerësoi se rezultatet në zbatimin e reformës në drejtësi janë suksesi më i madh i sesionit të kaluar. "Grupet parlamentare të lënë mënjanë luftën elektorale, jo ta pushojnë luftën, përkundrazi ta intensifikojnë. Ylli polar është hapja e negociatave, fitojmë të gjithë, fiton Shqipëria. Duhet të kontribuojmë të gjithë. Kuvendi ka hartuar tashmë një plan veprimi si edhe ka plotësuar një performancë të mirë. Duhet t'i ngjasojmë parlamentit kroat. Do t'ju kërkoja që këtë standard ta fillojmë dhe ta zbatojmë që në këtë sesion. Shtylla kryesore e Reformës në Drejtësi do të jetë vazhdimi i procesit të vetingut. Të këtë konsensus të gjerë nga të gjitha palët. T'i paraprijmë vitit dhe të rrisim etikën parlamentare", u shpreh Ruçi.

**TEATRI**

Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve për shtyrjen e dekretit për Teatrin, Ruçi u shpreh se s'është shtyrje, por kohë për shqyrtim më me përgjegjshmëri të vëretjtjeve të presidentit. "Nuk do e mendoja kështu, Konferenca e Kryetarëve u mblodh që të miratohet programi dhe kalendari. Përgatitëm draft-kalendarin. U kërkua një javë kohë për ligjin për Teatrin. S'është shtyrje, por përgjegjshmëri. Të mos të harrojmë që kemi një impenjim edhe nga Komisioni Evropian. Është fare normale që të diskutohet". "Lidhur me pyetjen e dytë, nëse maxhoranca do ta rrëzojë apo do ta miratojë, unë këtë nuk e di. Nuk jam këtu si përfaqësues i maxhorancës, por si përfaqësuesi i Kuvendit dhe përfaqësoj të gjitha sensibilitetet e Kuvendit, ndaj duhet të më kurseni lidhur me këtë çështje. Unë e kam deklaruar edhe herë tjetër, (vërtet i përkas maxhorancës dhe jam i zgjedhur nga maxhoranca), se që nga momenti kur do të zgjidhem, unë do të jem kryetar i Kuvendit të Shqipërisë. Sigurisht, unë kam të drejtën time që në Kuvendin e Shqipërisë, si çdo deputet tjetër, të jap mendimin apo votën time. Lidhur me interesimin e pyetjes suaj, le të presim datën përkatëse të seancës së parlamentit", u shpreh Ruçi.

**VAKANCAT NË KUSHTETUESE**
"Presidenti ka detyrimin kushtetues dhe ligjor që të ushtrojë kompetencën e tij për hedhjen e shortit. Në qoftë se ai nuk e ushtron këtë detyrë, është e drejtë e tij, ashtu sikurse ligji e ngarkon që, në qoftë se presidenti shprehet se nuk do ta ushtrojë këtë kompetencë ligjore, unë si kryetar i Kuvendit do ta ushtroj atë menjëherë", tha Ruçi.

**NDRYSHIMET NË QEVERI**

Sa u përket zërave për ndryshime të mundshme në qeveri nga kryeministri Rama, kreu i Kuvendit tha: "Kur trajtoj problemin e kontrollit, Kuvendi kontrollon qeverinë, në të gjitha aspektet, edhe procedurale dhe në instrumentet parlamentare dhe kam qenë rigoroz të korrigjojmë çfarë nuk kemi bërë mirë mes dy pushteteve. Për ndryshime në qeveri nuk është detyra ime. Si kryetar i Kuvendit, unë do të mirëprisja që instrumentet parlamentare, interpelancat, mocioni për debat, i besimit apo mosbesimit, në momentin dhe kohën që të kërkoheshin, unë do të ushtroj të gjitha kompetencat e mia që këto të kryhen".

**REFORMA ZGJEDHORE**

Ndër objektivat e Kuvendit, për këtë sesion është edhe reforma zgjedhore për të cilën kreu i Kuvendit, Ruçi u shpreh se reforma do t'u paraprijë zgjedhjeve vendore. Ai tha se kishte pritshmëri që komisioni i reformës zgjedhore do të kishte përmbushur misionin e tij, por kjo nuk u realizua. "Sigurisht që unë i kam nxitur të dy bashkëkryetarët të punojnë. Ne kemi njerëz, s'ka vakum ligjor, sigurisht kodi ekziston, por kemi edhe dy detyrime të domosdoshme për t'i shqyrtuar dhe për të dhënë verdiktin tonë: E para, janë tri palë zgjedhje, për të cilat ODIHR-i dhe OSBE-ja kanë bërë disa rekomandime, të cilat nuk janë implementuar. Kjo është një detyrë e papërmbushur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga forcat politike shqiptare. Në qoftë se të gjithë çirren dhe bërtasin se jemi proeuropianë, se e duam Shqipërinë si gjithë Europa, kjo fillon në radhë të parë nga standardi i zgjedhjeve dhe jo nga kokëfortësia për të mos zbatuar rekomandimet e organizmave ku ne aderojmë", tha Ruçi.

"Lufta ndaj terrorizmit s'do jetë e lehtë"

# Bushati: Do të prishim lidhjen mes radikalizimit e terrorizmit



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dje në Izrael

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati ndodhet në Izrael për punimet e "Konferencës së 18-të ndërkombëtare të luftës kundër terrorizmit", organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Luftës kundër Terrorizmit. Gjatë vizitës së tij, ministri Bushati zhvilloi disa takime bilaterale. Ai u takua me kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm të Izraelit, Benjamin Netanyahu; ministrin e Mbrojtjes, Avigdor Lieberman; ministrin për Bashkëpunimin Rajonal, Tzachi Hanegbi; lideren e opozitës, Tzipi Livni dhe drejtuesit e Komitetit Amerikano-Hebre (AJC) David Harris dhe Kongresit Botëror të Hebrenjve (WJC) Robert Singer. Ministri Bushati në fjalën e tij në konferencë prezantoi angazhimin dhe kontributin e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit e ekstremizmit të dhunshëm, duke e vënë theksin në shpalosjen e nismave të reja që lidhen me rolin e edukimit, harmoninë fetare, respektimin e të drejtave të njeriut e minoriteteve, vlerave të tolerancës ndaj diversitetit dhe në hartimin e zbatimin e politikave të posaçme strategjike, sociale, politike, ligjore, edukative dhe ekonomike. Bushati tha se, "lufta ndaj terrorizmit nuk është dhe nuk do të jetë e lehtë, por nuk ka alternative dhe nuk duhet të ndihet e dekurajuar. Ashtu si rrjetet terroriste janë transnacionale, kështu duhet të jetë edhe bashkëpunimi ynë. Ne duhet të bëjmë gjithçka që është e nevojshme për të prishur lidhjen mes radikalizimit dhe terrorizmit duke adresuar çështjet e mjedise ku ushqehen akte terroriste. Duhet të miratojmë një 'përpjekje të së gjithë shoqërisë', duke u angazhuar me shoqërinë civile, komunitetin, udhëheqësit fetarë dhe të rinjtë", u shpreh Bushati.

**DEKLARATA**
Z.Bushati tha se, "lufta ndaj terrorizmit nuk është dhe nuk do të jetë e lehtë, por nuk ka alternativë dhe nuk duhet të ndihet e dekurajuar. Ashtu si rrjetet terroriste janë transnacionale, kështu duhet të jetë edhe bashkëpunimi ynë".

Shehu: Kuvendi i Shqipërisë të mos qëndrojë pasiv, të mbrojë shqiptarët në rajon

# PD kundër ndryshimit të kufijve, përgatit rezolutë për Kosovën

## "Të ruhet forma unitare e shtetit"

Valentina Madani

Partia Demokratike po përgatit një rezolute në mbështetje të qëndrimit të forcave politike në Kosovë për mosndryshimin e kufijve. Rezoluta e Partisë Demokratike mbështet fuqimisht ruajtjen e formës unitare të qeverisjes në Republikën e Kosovës dhe reformat që sigurojnë anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe BE. Rezoluta që po përgatit Partia Demokratike mbështet fuqimisht reformat që sigurojnë anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Europian. "Rezoluta e Partisë Demokratike mbështet fuqimisht ruajtjen e formës unitare të qeverisjes në Republikën e Kosovës. Rezoluta që po përgatit Partia Demokratike mbështet fuqimisht reformat që sigurojnë anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Europian", thuhet në deklaratën e Partisë Demokratike lidhur me debatin më të nxehtë aktualisht në Kosovë, atë të korrigjimit të kufijve me Serbinë. Nga ana tjetër, deputeti i PD-së, Tritan Shehu shkruan në "Facebook": "E kam theksuar edhe ditë më parë se Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të qëndrojë pasiv përpara një çështjeje kaq të madhe për Kosovën, Shqipërinë, shqiptarët e rajonin tonë. Aq më shumë kur nga partnerët tanë si SHBA, personalitete të tyre nuk kanë shprehur asnjë entuziazëm për këtë 'projekt', kur kanë deklaruar se nuk do të bëhen pjesë e tij. Ndërsa nga ana tjetër, liderët kryesorë europianë si zj.Merkel e kanë quajtur atë tejet të rrezikshëm edhe për vetë stabilitetin e rajonit. Në të njëjtat linja kanë qenë edhe liderët e figurat kryesore politike shqiptare në rajon. Të vetmet zëra zyrtarë entuziastë për këtë 'projekt' kanë ardhur nga Beogradi, që në të vërtetë ka edhe autorësinë e vjetër të tij. I vetmi që nuk ka dhënë gjykim e mendim është kryeministri i ynë, gjë që po të analizohet në një kontekst më të gjerë, të bën ta klasifikosh atë si bashkautor. Në këto kushte - shprehet Shehu - Kuvendi me institucionet e tij si Komisioni i Jashtëm e deri te seanca plenare, duke shfrytëzuar mekanizmat përkatëse të tyre, duhet të vihen në lëvizje, jo thjesht për të qartësuar pozicionet e cilido, por veçanërisht për të qenë pjesë aktive në mbrojtje të arritjeve të mahnitshme të shqiptarëve në rajon, në këto 25 vite. Politika jonë kështu do të kontribuojë përsëri edhe për stabilitetin e rajonit, si dhe për konsolidimin e përshpejtimin e proceseve integruese të tij në BE e NATO. Veprime të tilla tonat pa asnjë dyshim shkojnë paralelisht jo thjesht me mbrojtjen e tërësisë territoriale të Kosovës, por edhe me vetë interesat tona të gjera kombëtare. Shpresoj që sot edhe Kuvendi i Kosovës të shprehet qartë në mbrojtje të tyre", shprehet deputeti i PD-së. Prej disa javësh Prishtina, por edhe Tirana janë përfshirë në debatin për ndryshimin e kufijve të Kosovës. Iniciatori i këtaj nisme të kundërshtuar gjerësisht është presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Duket se ndikimet e Sorosit tek ai kanë bërë që të pranojë ndryshimin e kufijve të Kosovës, në këmbim të njohjes së shtetit nga Serbia. Ndërkohë dje Kuvendi i Kosovës ka thirrur dy seanca të jashtëzakonshme. Seanca e parë është thirrur me kërkesën e Qeverisë së Kosovës dhe ka të bëjë me miratimin e ekipit negociator për dialogun me Serbinë. Seanca e dytë u thirr nga forcat politike në opozitë, e nxitur nga deklaratat e presidentit Hashim Thaçi për korrigjimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë.



**REZOLUTA**
Në rezolutën e saj, PD kërkon që të ruhen kufijtë aktualë dhe mbështet fuqimisht ruajtjen e formës unitare të qeverisjes në Republikën e Kosovës. Në rezolutë theksohet gjithashtu se Partia Demokratike mbështet reformat për anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe Bashkimin Evropian.



## Ambasadori i BE-së në Shqipëri, Luigi Soreca nis punën në Parlamentin Europian

Pas largimit të ambasadores së BE-së Romana Vlahutin, zëvendësuesi i saj në Shqipëri, italiani Luigi Soreca ka nisur punën për përfaqësimin e vendit në Parlamentin Europian. Në rrjetin e tij social "Twitter", ai postoi një foto nga Parlamenti Europian duke rikonfirmuar edhe njëherë mbështetjen e fortë të BE-së për integrimin e vendeve të Ballkanit. "Dita e dytë e konferencës së Ambasadorëve në Parlamentin Europian. Në mbledhje do të diskutohet për ekonominë, ndryshmet e klimës, migrimi dhe roli i BE-së në botë. Edhe njëherë rikonfirmohet mbështetja e fortë e BE-së për integrimin e vendeve të Ballkanit", shprehet Luigi Soreca, ambasadori i BE-së për Shqipërinë. Soreca u emërua në Shqipëri në datë 19 korrik pas largimit të Romana Vlahutin. Ai punon prej vitesh në rangje të larta në Bruksel dhe ka qenë i angazhuar me Shqipërinë gjatë procesit të liberalizimit të vizave. Luigi Soreca është njohës i mirë i çështje të sigurisë, i legjislacionit në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve të tjera të rënda. Ai ka punuar me EUROPOL dhe CEPOL.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA E LLOJIT 'PYLL + KULLOTË', ME SIPËRFAQE 190.000 M2, ZONA KADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NË PRONËSI TË Z. FATION UKA.
**ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.09.2018.**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

SHPALLJE ANKANDI

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 01.10.2018 ora 8ºº - 16ºº ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i III per shitjen e pasurise te paluajtshme Truall me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtesë me sipërfaqe 128 m², rregjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fq.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlere fillestare ne ankand 81,043 (Tetëdhjetë e një mijë e dyzet e tre) EURO .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

SHPALLJE ANKANDI

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me permbarues Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 02.10.2018 8 ora 8ºº - 16ºº ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I per shitjen e pasurise te paluajtshme Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 6/90, volumi 9 , faqe 174, zona kadastrale 1879 e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlere fillestare ne ankand 25,200 (Njëzet e pesë mijë e dyqind) EURO .
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

Ndryshon buxheti 2018, shkurtohen fondet për vetingun, Braçe kundër

# Ahmetaj: Pensionistët, 5 mijë lekë shpërblim në fund të vitit

## Do shpërndahen 3 miliardë lekë për 610 mijë pensionistë

Ornela Manjani

Të gjithë pensionistët do të marrin 5 mijë lekë shpërblim në fund të vitit. Fondi i vënë në dispozicion është 3 miliardë lekë, i cili do të ndahet për 610 mijë pensionistë në të gjithë vendin. Lajmin është bërë i ditur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj, i cili prezantoi në Komisionin e Ekonomisë ndryshimi e buxhetit 2018. Duke folur për ndryshimet buxhetore, ministri u ndal edhe tek efektet e kursit të këmbimit, i cili e ka goditur jo pak buxhetin në 8 muaj. Por pavarësisht pasojave negative, parametrat e buxhetit të ardhura/shpenzime nuk kanë ndryshuar.


Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

**KOMISIONI**

Komisioni i Ekonomisë ka miratuar aktin normativ, i cili ul me 3.5 mld të ardhurat si rezultat i zhvlerësimit të euros, ndërkohë që efekti në 8 muaj llogaritet 5 mld lekë më pak. Nga rishikimi i buxhetit përfitojnë pensionistët, të cilët do të marrin 5 mijë lekë shpërblim për fundvit, por shkurtohen fondet për vetingun, rrugët dhe bujqësinë. Kreu i Komisionit të Ekonomisë ngriti si shqetësim këto ndryshime, por për kreun e Financave ndryshimet janë bërë vetëm për atë pjesë të fondeve të papërdorura. Rishikimi i buxhetit 2018 i siguron pensionistëve një shpërblim prej 5 mijë lekësh për fundvit, por njëkohësisht shkurton fondet për një sërë institucionesh, përfshirë edhe vetingun. Në mbledhjen e parë të Komisionit të Ekonomisë për këtë sesion, kreu i komisionit Erjon Braçe ka ngritur një sërë pikëpyetjesh për shkurtimet e fondeve për rrugët, bujqësinë, por edhe për institucionin e vetingut. "Ajo që më shqetëson më shumë se dy të parat ka të bëjë me buxhetin e institucioneve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë. Zoti Ministër, në këtë institucion është krijuar një volum pune i jashtëzakonshëm për të përballuar detyrimet prioritare për të paktën një numër prej 57 gjyqtarësh dhe prokurorësh që ishin në proces rivlerësimi. Në dijeninë time ky proces po përfundon. Nuk e kuptoj këtë historinë e Ministrisë së Transportit, në atë territor që unë punoj janë pa mirëmbajtje që nga data 1 janar e këtij vit. Kanë 8 muaj pa mirëmbajtje. Ka vajtur ferra dhe është bërë 1 metër e gjysmë në çdo anë, nuk po flasim për kanale e gropa. Si ka rënë dakord që të uli para kur këto rrugë janë pa mirëmbajtje, çfarë efektiviteti qenka ky i performimit të parasë publike kur për 8 muaj nuk bëhet tenderi. Bie dakord që për shkak të performancës të ulen fondet, por ama duhen zgjidhur problematikat që janë krijuar në territori se për ndryshe pse nxjerrim para nga buxheti i shtetit për të financuar këtë projekt"-tha kryetari i komisionit Erjon Braçe. Por për Ministrin e Financave, Arben Ahmetaj, nuk ka shkurtim, por vetëm rishpërndarje të fondeve të papërdorura. Ka rënë dakord çdo ministër me ministrin e Financave dhe pastaj me kryeministrin për të gjitha rialokimet, për shkak të performancës, ecurisë 7 mujore, parashikimit të tyre në përputhje me parashikimin tonë"-tha Ahmetaj. Zhvlerësimi i euros përgjatë këtij viti duket se ka shtuar efektet negative në të ardhurat e buxhetit. Sipas Ministrit Arben Ahmetaj në 8 muaj ndikimi përllogaritet rreth 5 mld lekë." Buxheti vetëm në këtë korsi, për shkak të mbivlerësimit të lekut, ka pasur një goditje prej gati 5 miliardë lekë vetëm në kuadrin kohor të 8 muajve",-theksoi ministri. Akti normativ për rishikimin e buxhetit erdhi i detyruar si rezultat e mosrealizimit të të ardhurave me 3.5 mld nga efekti i zhvlerësimit të euros.

## Tabaku: Ahmetaj mashtron, 33 biznese mbyllen çdo ditë

Deputetja e PD, Jorida Tabaku reagoi pas konferencës për shtyp të ministrit Ahmetaj I cili foli për Aktin Normativ, situatën ekonomike në vend, punësimin etj. Tabaku tha se faktet tregojnë të kundërtën, se ekonomia është përkeqësuar, mungojnë investimet e huaja dhe borxhi është rritur. Sipas nënkryetares së Komisionit të Ekonomisë, 60 % e investimeve të huaja, me të cilat u krenua Ahmetaj, është nga TAP, investim i trashëguar nga PD. "Nga Janari Në Gusht Janë Mbyllur 9260 Biznese Ose 33 Biznese Në Ditë. Qeveria Po E Rishikon Buxhetin, Sepse Mungojnë 86 Milionë Dollarë, Ndërsa Borxhi Publik Është Rritur Ndjeshëm. Duke Llogaritur Edhe Ppp, Borxhi Është 83% Apo 20% Më I Lartë Sesa Kur Ps Mori Qeverinë. Arritja E Vetme E Qeverisë Është Rekordi I Saj Si Qeveria E Vetme Në Europë Ku Kredia Për Bizneset Bie, Por Lejet E Ndërtimi Rriten, Duke Dëshmuar Se Ekonomia Pastron E Pista." - tha Tabaku.

bashkëpunimi gjerman DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET**

The *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* GmbH (GIZ) is a federal enterprise that sup-ports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The objective of the programme reads: "The employment situation for employees and self-em-ployed, especially qualified young people, is improved." The programme follows a nation-wide approach. It has four fields of activity: (i) Vocational Education and Training, (ii) MSME Promotion, (iii) Social Initiatives and (iv) Investment Promotion & Policies and Strategies for Employment Promotion.
The component, **"Vocational Education and Training"** (TVET), aims to enhance the quality of vocational training and education and bring it closer to match the labour market demands. Thus it contributes to the implementation of the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020), focusing on the Strategic Priority A: "foster decent job opportunities through effective labour market policies" and Strategic Priority B: "Offer Quality vocational education and training for youth and adults".
The second area of action, **"Promotion of micro, small and medium-sized enterprises"** (MSMEs), aims at building MSMEs capacities to generate economic growth with positive effects in employment, with an eye on improving growth conditions that have an impact on employment and the increase of supply and demand for skilled workers. To that end, the programme will cooperate with clusters of micro, small and medium-sized enterprises, as well as with the business representative associations.
The third area of action, **"Social participation of youth and minorities"**, aims to support civil society social initiatives, focusing on the marginalized youth and teenagers.
The fourth area of action, **"Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment"**, aims at enhancing conditions for the implementation of relevant strategies and projects within selected ministries and their subordinate institutions, like, for example, the Business and Investment Develop-ment Strategy 2014 – 2020, and the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020). The programme will play an advisory role on the cross-cutting issues of the first and second areas of action, with particular focus on employment-related issues.

ProSEED builds on the integration of three previous projects, „Vocational Education and Training (Jan 2015 – Dec 2016), „Increasing the competitiveness of MSMEs by promoting innovation and entrepreneurship (ProSME, Oct 2014 - December 2016), and „Economic Good Governance for Improving the Investment Cli-mate "(Mar 2015 - Feb 2017). While the three forerunning projects covered certain segments in the area of promoting economic growth and employment (from the perspective of the labour offer, labour market demand and general conditions) through isolated interventions, the new programme intends to advance the approach applied so far and extend its scope by way of including new approaches aimed at employment promotion. In this context, the activities are complementary and favour a better matching of labour supply and demand match. The programme overall term is three years, starting from January 2017 until December 2019 (three years).

The programme contributes to reducing structural unemployment and underemployment, and to meeting the demands of the private sector with skilled workers. In this way, it tackles a thematic area of particular relevance to Albania and its further social and economic development.

**GIZ Office Albania seeks the following staff:**

***Junior advisor - SME, Support and Entrepreneurship-Development***

**A. Responsibilities**
The junior advisor "SME-Support and Entrepreneurship-Development":
■ Supports the management of programme activities according to programme goals, opera-tional planning and agreements with the partner structure, namely the Ministry of Finance and Economy and subordinate agencies. This implies support to planning, budgeting, im-plementation and contribution to monitoring of measures as well as provision of advice to partners in close coordination with the leadership of the programme;
■ This entails supporting the management of two intervention areas (i) provision of Business Development Services (BDS) to MSME (ii) provision of entrepreneurship trainings and start-up grants to aspiring entrepreneurs. In both cases, the supporting activities are deliv-ered by external institutions/experts but are to be accompanied and coordinated by the in-cumbent;
■ Support representation of ProSEED Private Sector Development component within the "start-up-eco-system", fostering exchange of concepts and cooperation between the differ-ent stakeholders in that community;
■ Contribute to knowledge management, monitoring and PR of ProSEED;
■ Support of GIZ tasks as assigned per need.

**The junior advisor performs the following tasks:**

**B. Tasks**
**1. Coordination and monitoring**
The junior advisor "SME-Support and Entrepreneurship-Development":
■ Supports program activities according to program goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies contributing to planning & budget-ing, implementation and monitoring of measures within and may entail the accompani-ment of external experts. The focus is on work with MSME, entrepreneurship trainings and start-up-support;
■ Supports the provision of grants to aspiring entrepreneurs and helps to ensure the smooth functioning of the IDEA-Grant-Assessment-Committee (IGAC) and the quantita-tive and qualitative monitoring of grant disbursement in close cooperation with the Pro-ject Implementation Unit (PIU) at the Ministry of Finance and Economy (MoFE);
■ Accompanies the provision of services for MSME and entrepreneurship trainings under the CEFE-methodology, contributing to both quantitative and qualitative monitoring;
■ Contributes to conceptualise the exploitation of synergies between stakeholders in the Albanian Start-up-eco-system and facilitates their exploitation;
■ Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned interven-tion areas in close coordination with the contract manager of the programme;
■ Supports planning, preparation and implementation of workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the program's field of activities.

**2. Communication and networking**
■ Assists the Head of Private Sector Development Component in establishing and in-creasing ProSEED visibility among stakeholders for MSME and entrepreneurship-sup-port;
■ Actively networks on behalf of GIZ in the relevant community;
■ Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme.

**3. Knowledge management**
■ Assist in improving the program's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
■Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer and linkages' exploitation especially among the ProSEED team;
■ Supports the preparation of appropriate input to the various project/program reports/publi-cations including annual reports; contributes to other reports required by the AV and the GIZ Headquarter

**A. Required qualifications, competences and experience:**

■Master's degree in Economics, Education, Social Sciences, Business Administration, or other relevant fields
■Work experience with regards to entrepreneurship/MSME and start-up-support
■Minimally 2 years of professional working experience in a similar position related to entre-preneurship, MSME and start-up-support
■Strong record of professional expertise in his/her field
■Excellent command of MS-Office
■Good working knowledge of modern telecommunication systems
■language skills (must include Albanian & excellent spoken and written English)

**Contract conditions:**
■Full-time employment
■Programme office in Tirana
■ Assigment period: until 31.12.2019

Please forward your application until **18 th of September 2018,** to GIZ Office Albania by E-Mail: **giz-albanien-hr@giz.de** including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

***GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!***

Procedurat për pajisjen me tapi të ndërtimeve të legalizuara ndiqen nga Agjencia

# ALUIZNI, 950 personat që do të marrin lejet

## *Përfituesit në qarkun e Shkodrës*

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 950 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë gati lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në qarkun e Shkodrës. Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër bën të ditur se qytetarët që gjejnë emrin në listë të paraqiten pranë kësaj drejtorie për të tërhequr lejen e legalizimit, në rast të mosparaqitjes së tyre brenda një jave, leja do të dërgohet nëpërmjet shërbimit postar në adresën e objektit të legalizuar. ALUIZNI bën të ditur se brenda pak kohësh të gjithë përfituesit do të pajisen me tapitë për pronën dhe se vonesat në shqyrtimin e dosjeve dhe pajisen me leje kanë marrë fund.

**TAPITË**

Procedurat për marrjen e tapive do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në hipotekë. Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesit do të njoftohen për tërheqjen saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërkohë që çdo muaj ALUIZNI bën gati rreth 3 mijë leje në të gjithë vendin. Sipas ligjit në fuqi, kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit të objektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve.

**PERSONAT QË DO TË MARRIN LEJET**

LEZHE

1 PAULIN PAL HILA
2 PASHK LEKE MERDHOQI
3 PASHK PJETER GJINI
4 EDMOND PJETER SYZIU
5 PASHK LEKE MERDHOQI
6 PETRIT NIKOLL NDOKAJ
7 FRAN ZEF BOÇI
8 LLESH NIKOLL GJONI
9 BIB GJERGJ GJONAJ
10 VALENTIN PREND COLI
11 VALENTIN PREND COLI
12 XHEMAL MURAT ZYBA
13 GEZIM DED SOKOLI
14 PRENGE LLESH GJIKOLAJ
15 FRAN KOL KALTHI
16 GJIN PJETER LLESHI
17 MARK JAK SHQUTI
18 ZEF NDREK LLESHAJ
19 GJON NDUE GJERGJI
20 FIQIRI OSMAN BALAJ
21 VIKTOR LLESH NDREU
22 ALEKSANDER BARDHOK GJONAJ
23 NIKOLL GJETE GJIKA
24 LUIGJ NDUE TUSHAJ
25 PJETER NDUE BIBA
26 NOK KOL MARKU
27 PAL NIK MARKU
28 PLLUMB GJERGJ NDRESHAJ
29 PAL NIKOLL LLESHI
30 LLESH FRROK NIKOLLI
31 DAVE BARDHOK RAJTA
32 SUTE NDUE NDOU
33 NDREK MARK UKA
34 NDUE MARTIN MARKU
35 PREL MARTIN MARKU
37 VIKTOR NIKOLL SOKOLI
38 ZEF NDOK KOLA
39 KOLE BIBE BUSHI
40 PRENE PRENDUSHNIKOLLA
41 GJERGJ PJETER PERDODA
42 GJERGJ MARK GJOKA
43 PJETER BEC LEKAJ
44 ÇLIRIM ZYLYF MUÇA
45 MARTIN PAL SALLAKU
46 AGIM ISLAM ZEQIRI
47 NDUE ZEF GJEÇI
48 KOL GJOK PJETRI
49 PETRIT MARK PICAKU
50 PREND NIKOLL SHERRI
51 DRITAN NDUE CANGA
52 NDOC GJON PERGJONI
53 ZEF NDOC ZEFI
54 ARDIANA MARKU MARKU
55 NIKOLL NDUE PRENDI
56 BARBULL FRROK GJOKA
57 HALIL BAJRAM SALIU
58 GJET MARK MARKU
59 FRAN GJON PERGJONI
60 GJOVALIN TOME VULAJ
61 ILIR GJIN BILAÇAJ
62 GJON MARTIN PRELAJ
63 LLESH TOME SHABI
64 ERMIR LUIGJ STAKA
65 NIKOLL NDREC TANUSHI
66 DED PRENG DEDA
67 NDUE KOL MHILLAJ
68 KRISTO MARK KOLA
69 FLAMUR ASLLAN MILLA
70 NIKOLIN PAL TUSHA
71 GJOVALIN MARK DEDA
72 TOM NDOC SHTJEFNI
73 LEK LLESH JAKU
74 PASHK FRAN METAJ
75 ALEKSANDER KOL LETI
76 MHILL GJON GJINAJ
77 MUHARREM VESEL LAMAJ
78 BESNIK XHELAL LAMAJ
79 PASHK MARK NIKOLLI
80 GJOVALIN KOL PERLLESHI
81 ÇESK PAL UJKAJ
82 VIKTOR GJELOSH ÇOTAJ
84 XHULIAN PETRIT NDOCI
85 PREND TOM NDOCI
86 JAK PREK MARKU
87 JAK NDUE MICI
88 NDUE MARK PRENGA
89 NIKOLIN PJETER PALI
90 PASHKE NDUE POPA
91 PAVLIN PAL PREKA
92 LAZER PAL PEMAJ
93 AGRON DED NDOCI
94 PJETER VLASH PEMAJ
95 ALTIN PJETER PEMAJ
96 SHKELQIM KURT ALIU
97 GJIN NIKOLL NDOCI
98 SHABAN RAMAZAN MYRTA
99 GJERGJ FRROK PALI
100 MUSTAFA OSMAN SEFA
101 PRENDE NDUE GJOKA
102 PRENG NDREC ZEFI
103 PRENG GJETE MARKU
104 ARBEN ZEF PRENGA
105 ANTON NIKOLL MARKU
106 NDUE ZEF PALI
107 GJON MARK BAJRAKTARI
108 PAJTIM GJET DEDA
109 GJON PRENG ÇUNI
110 SEFEDIN ALI PASHKAJ
111 GJERGJ ZEF KECI
112 LUK DED TOMA
113 PAL NIKOLL LLESHI
114 TOM GJIN GEGA
115 LEK LAZER FRROKU
116 SANDER PRENGE LLESHI
117 NIKE PJETER BASHAJ
118 HASAN SALI LIKA
119 IZEDIN MUHARREM KADIJA
120 AGOSTIN LAZER VESHTI
121 GEZIM PRENG LLESHI
122 MIRASH NDUE LEKAJ
123 NIKOLL NDREC LLESHI
124 DAVIDA LAZER NIKOLLI
125 AGUSTIN NIKOLL GJONI
126 GJOVALIN MARASH GILAJ
127 PRENG FRROK NDOJ
128 FRED PAL NDOKA
129 MHILL LULASH LULA
130 MONDI NIKOLL NDOJ
131 GAZMEND PRENG NIKOLLI
132 PETRIT GJERGJ PEMAJ
133 ALEKSANDER PJETER UJKA
134 GJERGJ NIKOLL MATRIZI
135 SHOQERIA V.A.L.E RECYCLING SH.P.K
136 SHOQERIA V.A.L.E RECYCLING SH.P.K
137 KOLE GJERGJ GJERGJI
138 MHILL GJIN LEKA
139 VLASH NDUE PREÇI
140 FLORIN TOM ÇUKU
141 TONIN MHILL GJONI
142 PJETER ZEF BIBA
143 MARIE FRROK NIKOLLI
144 PALI NDUE PERVATAJ
145 FRROK PREK VATAJ
146 PASHKO ZEF BARDHAJ
147 BUKURIJE LUTO ALIAJ
148 GJELOSH BARDHOK PRENDI
149 NIKOLL NDUE JAKU
150 GJOVALIN NDUE PRENGA
151 GJON MARK MARKU
152 EDUARD MARK PICAKU
153 NDUE NDUE LUGJA
154 PJETER NDUE LLESHI
155 MHILL GJERGJ NDOJ
156 LEK GJERGJ NDOJ
157 LEK NIKOLL BUSHKOLAJ
158 BIBE MARK NDOCA
159 LEK TOM MARKU
160 MARK NIKOLL GJERGJI
161 ARDIANA MARK MARKU
162 SIMON NDUE NDREKA
163 PAL ZEF SHKURTI
164 ZEF NDUE MARKU
165 GJIN MARK VUKSANI
166 MIRASH LLESH LLESHI
167 KOL LEK PIROLI
168 ALEKSANDER PRENG TUSHAJ
169 DEDE NDUE NDOJ
170 ZEF LUK MARKU
171 MARK CUB MANDREU
172 ALEKS LUIGJ PRODANI
173 NDUE NIKOLL PRELA
174 GJOK ZEF GJOKA
175 ALI HAZIS GJATA
176 GEZIM KOL DEDAJ
177 SOKOL MARK MALUTA
178 ROLAND MARK PJETRI
179 LEK ZEF MARKU
180 PAULIN FRAN PREKA
181 LEK GJERGJ MARKU
182 ELENI SPIRO PAPA
183 GJERGJ NDUE KECI
184 PJETER PRENG PEPA
185 GJOK DED KAÇORRI
186 MARK NDUE MARKU
187 FRAN MARASH MARTINAJ
188 VILSON FRROK BILAÇI
189 FRAN GJELOSH POPAJ
190 FRROK NDUE LIKA
191 FATMIR DREGUT REXHA
192 GJERGJ NDUE VULAJ
193 GZIM LUSH MARKU
194 MUSA RIZA KARAMUÇA
195 MARK NIKOLLE PEMAJ
196 FRROK NDUE FRROKU
197 PJETER MARK BIBA
198 GJERGJ ZEF GJEÇI
199 LLESH NDOK NDOJ
200 ZEF FRROK ZEFI
201 DASHAMIR PASHKO QUSHKU
202 FERDINANT NDREKE BRRUKU
203 PJETER PAL SHAHINI
204 DEJVI LUIGJ SHYTI
205 PETRIT MARK ZEFI
206 MONDI TOM GJONI
207 MONDI LLESH SHTJEFNI
208 KLEMEND GEG SHAHINI
209 PJETER NIKOLL MENGA
210 SANDER LAZER NDOJ
211 MUHAMET ISA DUKA
212 GJIN LLESH GEGA
213 NDREC PJETER FRROKU
214 ARBEN GEG SHAHINI
215 TOM MARK MARASHI
216 ZEF NDUE GJINI
217 PETRIT FRROK FRROKU
218 PRENGE FRROK PJETRI
219 ISMAIL HAXHI MARKAJ
220 VITOR PAL MALAJ
221 NIKOLL BIB LLESHAJ
222 MUHAMET IDRIZ DUSHKU
223 ARBEN MARK NDOCI
224 GJOKE LLESH MRRUKU
225 MUHAMET ISA DUKA
226 DODE LAZER NDOI
227 VIKTOR NDUE KUÇAJ
228 ZEF GJON SKURA
229 FATMIR SULEJMAN TAFA
230 PJETER MARK NDOJA
231 FRAN SIMON DODAJ
232 VIOLETA PASHKO PREÇI
233 KISHA KATOLIKE " DIOQEZA E LEZHES "
234 ESAT MUSTAF DUSHKU
235 KOLE ZEF PRENGA
236 LANDI ZEF DODAJ
237 NIKOLL NDOC SIMONAJ
238 NDUE NIKOLL MULA
239 GJON PRENG MRRUKU
240 PETRIT TOM GJEKA
241 LUIGJ NDREC ZEFI
242 ZEF GJET TANUSHI
243 GJOVALIN GJOK MICI
244 ZEF GJET TANUSHI
245 HIL NIK COLI
246 DILE KOL MARKU
247 FRROK NIKOLL HILA
248 FERDINAND LUIGJ PALAJ
249 HIL LLESH GEGA
250 GJERGJ JAK JACI
251 LEK GJIN FUSHA
252 ANILA KOL SMAKAJ
253 KISHA KATOLIKE " DIOQEZA E LEZHES "
254 LUIGJ GASPER COLI
255 PASHKO GJOK MARKU
256 LLESH GJON NDRECA
257 KASTRIOT GJIN LLESHAJ
258 TRIFON LAMI GOGA
259 PREND NDUE NDRECA
260 LUIGJ ZEF FRROKU
261 SANDER FILIP PALI
262 KOL NDOK NDOJ
263 PAL FRROK ZEFI
264 VLASH GEG PRENDI
265 PAULIN GJOVALIN PALUSHAJ
266 PAULIN GJOVALIN PALUSHAJ
267 MARK MATI PJETRI
268 GJON DEMUSH PJOLLAJ
269 LLESH GJOK GEGA
270 PETRIT FRROK MARKU
271 PJETER NDUE PJETRI
272 PAL NIKOLL SIMONAJ
273 PAL NIKOLL GJONI
274 PERPARIM FERIZ SYLA
275 ZEF NIK MARASHI
276 ARBEN MARK NDOCI
277 DRANDE GJIN PREKA
278 ARBEN SIMON DODAJ
279 SHTJEFEN PJETER COLI
280 KOL PAL GJOKA
281 RAMAZAN HABIB KOÇI
282 VASIL PAL HABERI
283 GJON NIKOLL MAKAJ
284 PASHUK FRROK GJOKA
285 NARDI KOL NDOJ
286 PETRIT MARK NDRECA
287 MARTIN PAL PEMAJ
288 FATMIR PAL PEMAJ
289 VLASH PREND NIKA
290 FRROK NDUE PJETRI
291 NDREC SIMON DOÇEJ
292 JAK PJETER GJONI
293 GAC LAZER ZEFI
294 FRROK LLESH NDOJ
295 PREND GEG BIBAJ
296 PALINE MARK NDOJ
297 DED ZEF MARKU
298 ZEF NIKOLL MARKU
299 VALENTINGJOVALIN MARKU
300 ALEKS NIKOLL NDOJ
301 DRITAN NIKOLL DOÇEJ
302 KOLEC MARK HILA
303 ZEF NDUE NDOCI
304 PASHKO PAL NDRECA
305 GJERGJ NDUE MICI
306 LLESH MARK MARKU
307 GLEDIS PAULIN CAMAJ
308 BUKURIE GJON MARASHI
309 ARTJOL ZEF ÇUPI
310 PJETER GJON KOLA
311 KUJTIM GJON GJOKA
312 LUIGJ GJETO PALAJ
313 DEJVI LUIGJ SHYTI
314 PETRIT MARK ZEFI
315 MONDI TOM GJONI
316 MONDI LLESH SHTJEFNI
317 KLEMEND GEG SHAHINI
318 PJETER KOL MENGA
319 SANDER LAZER NDOJ
320 MUHAMET ISA DUKA
321 GJIN LLESH GEGA
322 NDREC PJETER FRROKU
323 ARBEN GEG SHAHINI
324 TOM MARK MARASHI
325 MIRANDA PASHK TOSKU
326 VASIL MARK PERLIKA
327 JETMIR LLESH NOKA
328 PETRIT PASHK HILA
329 MARK PRENG CILI
330 FRAN PJETER MARKAJ
331 GJERGJ NDUE MARSHTJEFAJ
332 FRAN PRENG PEPA
333 PAL PJETER LLESHAJ
334 PAVLIN GJON GJONI
335 PAL DED PRENGA
336 PAL MARK PERJAKU
337 EDMOND MARK DODA
338 ALEKSANDER BARDHOK GJONAJ
339 MARK NDUE TOKRRI
340 NDREC NDUE NDOCI
341 GEZIM MUSTAFI XEKA
342 NDRE BARDHOK BUSHPEPA
343 NIKOLIN HIL HILA
344 GEZIM NDREC BOÇI
345 RROK PREK RUDI
346 PJETER KOLE ÇUNGU
347 FRAN GJOK RUDI
348 NDUE ZEF DODAJ
349 PASHKO PREL NIKA
350 BARDH NDREC MARKU
351 PAL PRENGE MARKAJ
352 PREK NDREK NDREU
353 GJOVALIN PRENGE PICAKU
354 PREND NIKOLL SHERRI
355 ARBEN LLESH TOMA
356 NIKOLL PAL BEGU
357 FRROK MARK PRENGA
358 BIB NDUE NIKOLLI
359 NDUE ZEF MARKU
360 PREND PALE PERNDOJ
361 PRENG PJETER GJOKA
362 GJOK PRENG GJOKA
363 NDUE NIKOLL BARDHI
364 LUIGJ NIKOLLE HASI
365 SPIRO PRENG FRROKU
366 GJERGJ NIN MARGJINI
367 PRENG FRROK LLESHI
368 KOLIN ZEF LEKA
369 BARDHE GJIN BIBA
370 PJETER MARK GJOKA
371 VALENTIN NIKOLL LULAJ
372 LULE DED ULNDREAJ
373 GEZIM NDUE ZEFAJ
374 PAL ZEF GJERGJI
375 PJETER NIKE UCI
376 NDOC LUIGJ KASNECI
377 HAXHI XHEMAL ZIRA
378 LLESH GJOK DEDGJONAJ
379 ERVIN SKENDER KASMI
380 DED KOL PALOKA

53-vjeçari, nën akuzë për veprën penale "Kanosje për shkak të detyrës"

# Pronari i lokalit në Laç kërcënoi gazetarin, policia: Rasti i kalon prokurorisë

## "Gjatë kontrollit biznesmenit Llesh Buraku nuk iu gjet armë"

KURBIN

Pas ngjarjes së ndodhur mëngjesin e së hënës në Laç, ku pas një shpërthim me tritol në një lokal, pronari i biznesit kërcënoi gazetarët, reagon policia e Kurbinit. Kujtojmë se pronari i lokalit Llesh Buraku, nuk lejoi gazetarin e News24 Prend Shota të filmojë pasojat e sulmit në lokal, madje e kërcënoi me armë që të largohet nga ambientet e biznesit. Policia e Kurbinit njoftoi se materialet referuar shtetasit Buraku, (pronari i biznesit) i janë referuar prokurorisë. "Në lidhje me një lajm të publikuar në median elektronike ku shtetasi J.Sh., me profesion gazetar, është kanosur gjatë kryerjes së detyrës si dhe i ka dërguar mesazh shefit të Komisariatit të Policisë Kurbin ku i ka kërkuar ndihmë dhe ky i fundit nuk i është përgjigjur, ju sqarojmë se: Nga specialistët e Seksionit për parandalimin dhe hetimin e ngjarjeve kriminale në Komisariatin e Policisë Kurbin, u referuan materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, në ngarkim të shtetasit Ll.B., 53 vjeç, banues në Kurbin, për veprën penale "Kanosje për shkak të detyrës". Kjo pasi më datë 03.09.2018, rreth orës 15:00, është paraqitur pranë Komisariatit të Policisë Kurbin shtetasi J.Sh., i cili ka kallëzuar se rreth orës 07:00, ka shkuar për të pasqyruar ngjarjen e ndodhur në lokalin ku i është vendosur lëndë eksplozive, dhe është kërcënuar me armë zjarri nga pronari u lokalit, për moslejimin e filmimit të vendngjarjes. Me marrjen e informacionit nga njoftimi i shtetasit J.Sh. te policia e Lezhës rreth orës 09:00, është ngritur grupi hetimor nën drejtimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, duke kryer të gjitha veprimet hetimore konform rregullave. Nga kontrollet e ushtruara në ambientet në pronësi të shtetasit Ll.B., nuk është konstatuar asnjë armë zjarri apo send tjetër i kundërligjshëm",-thuhet në njoftimin e policisë. Gjithashtu, në lidhje me sms-në e publikuar të dërguar nga shefi i Komisariatit të Policisë Kurbin shtetasit J.Sh., policia njoftoi se nuk ka lidhje me ngjarjen, pasi sipas uniformave blu mesazhi që shtetasi J.Sh. pretendon se i ka dërguar shefit të Komisariatit Kurbin ku i shpjegon ngjarjen dhe i kërkon ndihmë, nga verifikimet hetimore ka rezultuar se nuk i është dërguar fare shefit të Komisariatit Kurbin, duke mos u vënë në dijeni ai se çfarë po ndodhte.






## Vetingu, caktohet trupa gjykuese që do shqyrtojë kreun Kushtetueses në KPA

**TIRANE** -Pak kohë pas ankimimit të Komisionerit Publik lidhur me konfirmimin në detyrë të kreut të Gjykatës Kushtetuese Bashkim Dedja, duke kaluar vetingun, vjen veprimi i radhës nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Mësohet se KPA ka hedhur shortin për çështjen e Dedjes, ndërsa trupa gjykuese do të kryesohet nga Ardian Hajdari. Kujtojmë se gjyqtari Dedja u rikonfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 13 qershor, vendim që u ankimua edhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. "Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është regjistruar çështja (JR ) Nr. 10/2018, datë 31.07.2018 që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 24, datë 13.06.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Bashkim Dedja. Në datën 04.09.2018, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, u hodh shorti për caktimin e trupit gjykues, kryesuesin e këtij trupi dhe relatorin e çështjes. Trupi gjykues i caktuar me short është i përbërë nga: Kryesues: Ardian Hajdari; Relator: Luan Daci; Anëtarë: Albana Shtylla, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz",-thuhet në njoftimin e KPA.




## Djegia e makinës në Vlorë e qëllimshme, policia arreston autorin

**VLORË**- Policia e Vlorës ka arritur të zbardhë ngjarjen e ndodhur në këtë qytet ku u dogj një automjet dy net më parë dhe ka vënë në pranga autorin. Seksioni për Krimet pranë Komisariatit të Policisë Vlorë, ka ndaluar shtetasin Shkëlqim Hoxha, 41 vjeç, banues në këtë qytet, i cili dyshohet ta ketë kryer këtë vepër penale në mënyrë të qëllimshme. Ngjarja ndodhi rreth orës 4 të mëngjesit të së hënës në lagjen "24 Maji" ku u përfshi nga flakët automjeti tip "Toyota" me targa AA 660 RJ në pronësi të shtetasit S.S.. Materialet iu referuan Prokurorisë për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr", parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.

**Zhvillohet ceremonia e dorëzimit të automjeteve të dhuruara**

# Gjermania i jep 10 makina me vlerë 127 mijë euro Policisë Kufitare

Policia Federale Gjermane i dhuron 10 automjete me vlerë 127 mijë euro Policisë Kufitare për shërbimet e mbikëqyrjes së kufirit. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të automjeteve të dhuruara. Ambasadorja Gjermane në Shqipëri, Zj.Susanne Schutz e pranishme në ceremoninë e dhurimit e cilësoi bashkëpunimin me Policinë e Shtetit si të shkëlqyer, dhe premtoi se edhe në të ardhmen policia dhe qeveria gjermane do të mbështesin Policinë e Shtetit qoftë në asistencë teknike ashtu edhe në atë logjistike si dhe inkurajoi drejtorin Veliu për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Ardi Veliu, e vlerësoi si mjaft efikase këtë ndihmë dhe theksoi se bashkëpunimi me partnerët është prioritet i punës së Policisë së Shtetit. Këto automjete do shërbejnë në rritjen e forcës goditëse si dhe në kontrollin më të mirë të kufirit tokësor për parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme si dhe të migracionit të paligjshëm. "Për Policinë e Shtetit, bashkëpunimi me partnerët është një faktor kyç, në arritjen e suksesit në luftën kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkufitar. E vlerësojmë dhe e çmojmë shumë të rëndësishëm këtë mbështetje qoftë në asistencë profesionale ashtu edhe me ndihmë logjistike dhe teknike. Gjej rastin të konfirmoj se në këtë drejtim shteti gjerman ka dhënë një kontribut të çmuar ndër vite. Është fakt tashmë që marrëdhëniet e bashkëpunimit me autoritetet ligjzbatuese gjermane dhe sidomos me policinë gjermane, janë të shkëlqyera. Sot po na dhurohen 10 mjete, me një vlerë 127 mijë euro, të cilat janë të destinuara për mbikëqyrjen në kufirin tokësor, ndërkohë që në janar të vitit 2017, u dhuruan dhe 5 automjete të tjera me vlerë 80 mijë euro. Tashmë bashkëpunimi midis policive tona është konkret dhe aq më tepër operacinal, përmend këtu realizimin e operacionit të përbashkët me vendet e rajonit "Drino 2018", ku nëpërmjet Agjencisë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar GIZ, qendra Federale Gjermane bashkëfinancoi zhvillimin e këtij operacioni.

Ne po punojmë së bashku për më shumë siguri dhe për më tepër po unifikojmë veprimet tona për të realizuar objektivat në luftën kundër paligjshmërisë. Ndaj e vlerësoj dhe e konsideroj shumë të rëndësishme këtë ndihmë pasi është një kontribut i drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve të policisë kufitare për mbikëqyrjen e kufirit",-deklaroi Veliu.




**Emigrantët në Itali, shqiptarët të tretët për sa u përket veprave penale**

Numri i veprave penale të kryer nga shtetasit shqiptarë në 2016-n në Itali ishte 7575, të renditur pas rumunëve, me rreth 16348 krime dhe marokenëve me 6115 denoncimeve. Në raport me numrin e shqiptarëve që kanë emigruar në Itali, "Il Sole" përllogarit se në çdo 100 emigrantë, rreth 1.23 ka kryer një vepër penale. Ndërsa krimet nga vetë italianët, sipas të dhënave të publikuara nga Infodata e Il Sole 24, është 66,477, ku sipas përllogaritjeve në çdo 100 italianë, 0.11 kanë kryer një vepër penale. Për sa i përket renditjes më poshtë, për numrin më të lartë të denoncimeve bazuar mbi kombësinë, renditet Tunizia me 2233 denoncime, Moldavia me 1400 dhe Bosnja me rreth 1300. denoncime.

## Dy të miturit kalojnë në kujdesin e motrës së gjyqtares

# Vrasja e Fildez Hafizit, gjykata i heq kujdestarinë e fëmijëve Fadil Kasemit

Rreth një vit pas vrasjes së gjyqtares Fildeze Hafizi nga ish-bashkëshorti në kryeqytet, Gjykata e Tiranës i heq kujdestarin e fëmijëve Fadil Kasemit. Kujdestaria e fëmijëve i ka kaluar motrës së gjyqtares, ndërsa babai ndodhet në burg për të vuajtur dënimin. Amela Hafizi Asllanaj motra e gjyqtares së vrarë në 31 gusht nga ish-bashkëshorti, ka depozituar në Gjykatën Civile të Tiranës një javë pas ngjarjes, një kërkesë për kujdestarinë e fëmijëve të së ndjerës. Në seancën, e cila u mbajt më herët, u thirr për t'u njohur me kërkesën, babai biologjik i vajzës dhe djalit të mitur, Fadil Kasemi, i cili akuzohet për vrasjen e nënës së tyre. Mësohet se ai ka refuzuar që fëmijët t'i dorëzohen tezes së tyre, duke kërkuar që kujdestarinë ta marrin të afërmit e tij. Avokati mbrojtës i Fadil Kasemit, Ndue Pjetra, ka shpjeguar se klienti i tij mund t'u siguronte të miturve banesë dhe të ardhura të mjaftueshme financiare për rritjen dhe edukimin e tyre. Ditën e djeshme gjykata e Tiranës vendosi që kujdestaria t'i kalojë motrës së viktimës. Me datë 31.08.2017, rreth orës 13:50, në rrugën "Xhanfize Keko", Tiranë, shtetasja Fildez Hafizi ka dalë nga parkeria dhe është futur brenda në automjetin e saj të parkuar aty pranë. Në këtë kohë është afruar ish-bashkëshorti i saj, shtetasi Fadil Kasemi me një pistoletë në dorë dhe ka qëlluar me armë në drejtim të gjyqtares Hafizi, duke e lënë të vdekur në vend. Më pas 53-vjeçari me pistoletën në dorë i ka dalë përpara një automjeti të rastit që po udhëtonte në drejtim të rrugës 'Bardhyl', të cilit i ka thënë se kishte vrarë bashkëshorten e tij dhe nën kërcënimin e armës i ka kërkuar atij që ta largonte nga vendi i ngjarjes duke hipur brenda në automjet. Gjatë udhëtimit shoferi i automjetit ka përshkuar rrugën që të dërgonte pranë Komisariatit të Policisë nr.1 Tiranë. Në kohën që i është afruar Komisariatit shtetasi K.T. e ka futur menjëherë automjetin e tij brenda në ambientet e Komisariatit të Policisë. Në këtë moment janë afruar menjëherë punonjësit e policisë, të cilët kanë ndërhyrë dhe kanë bërë kapjen në flagrancë të shtetasit Fadil Kasemi duke i hequr armën pistoletë që mbante në duar.

**KUJDESTARIA**

Gjykata e Tiranës i heq kujdestarinë e fëmijëve Fadil Kasemit, duke ia kaluar motrës së gjyqtares, ndërsa babai ndodhet në burg për të vuajtur dënimin. Amela Hafizi Asllanaj, motra e gjyqtares së vrarë në 31 gusht të vitit të kaluar nga ish-bashkëshorti, ka depozituar në Gjykatën Civile të Tiranës një javë pas ngjarjes, një kërkesë për kujdestarinë e fëmijëve të së ndjerës.



Gjyqtarja Fildeze Hafizi

## Operacioni në kryeqytet, kontrolli i policisë "fundosi" trafikantët

# Kapen me drogë dhe armë në Tiranë, arrestohen tre persona

## *Sekuestrohen 2.5 kg "heroinë", 'Shotgun' dhe fishekë*

Ina Allkanjari

Tre persona janë vënë në prangat e policisë së Tiranës dhe një tjetër është shpallur në kërkim pas një operacioni të zhvilluar në orët e mbrëmjes së të hënës për shpërndarje të drogave dhe armëmbajtje. Uniformat blu kanë bërë të ditur se kanë goditur një rast të shpërndarjes në doza të vogla të drogave të forta, ndërsa kanë sekuestruar edhe lëndë narkotike të llojit të dyshuar "Heroinë", armë zjarri e municion luftarak. Operacioni u zhvilluar nga Forca e Posaçme e DVP Tiranë dhe Sektori Kundër Narkotikëve. Konkretisht nga shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve Luan Çela, 44 vjeç, banues në Tiranë; Romeo Ramadani, 32 vjeç, banues në Tiranë; Mario Menga, 39 vjeç, banues në Tiranë si dhe u shpall në kërkim shtetasi A. D., 41 vjeç, banues në Tiranë. Në rrugën "Kujtim Laro" gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin me targë AA 821 OG, me drejtues shtetasin Luan Çela dhe pasagjer shtetasin Romeo Ramadani, është gjetur një qese brenda të cilës ndodhej një kuti me 5 pako të mbështjella me natriban. Gjithashtu, dhe gjatë kontrollit të ushtruar në banesat e shtetasve Luan Çela dhe Romeo Ramadani janë gjetur përsëri një sasi e dyshuar lënde narkotike dhe municion luftarak. Sipas uniformave blu janë sekuestruar në total në cilësinë e provës materiale 2.5 kg lëndë narkotike e dyshuar e llojit "Heroinë", automjet, 1 'shotgun', 1 armë gjahu, 16 fishekë arme gjahu, dylbi, fishek arme zjarri kalibër 7.62 mm si dhe 45 fishekë manovre. Gjithashtu, policia e Tiranës bën me dije se gjatë kontrollit të ushtruar në një lokal në zonën e "Astirit" u bë arrestimi i shtetasit Mario Menga. Këtij shtetasi iu gjet një armë zjarri tip pistoletë pa leje, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve L. Ç., R. R., dhe A. D., për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit e kryer në bashkëpunim", dhe "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim", ndërsa për shtetasin M. M., për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe i municionit luftarak".



**TË ARRESTUARIT**

- Luan Çela, 44 vjeç, banues në Tiranë.
- Romeo Ramadani, 32 vjeç, banues në Tiranë.
- Mario Menga, 39 vjeç, banues në Tiranë

**U SHPALL NË KËRKIM**

- A. D., 41 vjeç, banues në Tiranë

**SEKUESTRIMET**

- 2.5 kg lëndë narkotike e dyshuar e llojit "Heroinë"
- Automjet
- 1 'shotgun'
- 1 armë gjahu
- 16 fishekë arme gjahu
- dylbi
- fishek arme zjarri kalibër 7.62 mm
- 45 fishekë manovre
- 1 armë zjarri tip pistoletë

### Arrestohet çifti shqiptar në kufi me Greqinë, i gjenden në makinë 85 pako marijuanë

Policia greke ka zhvilluar dy operacione në kufirin greko-shqiptar ku ka sekuestruar 192 kg marijuanë. Në operacionin e parë, i cili u zhvillua mbrëmjen e së hënës në Nerajdha, Igumenicë, u ndalua një automjet brenda të cilit u gjetën dhe sekuestruan 99 pako me 106 kg 740 gram marijuanë. Në kuadër të këtij operacioni u arrestuan dy shtetas grekë, një burrë 47 vjeç dhe një grua 46 vjeçe. Ndërkohë në operacionin e dytë në Menidhi, Aitiloakarnania, u arrestua një çift shqiptar, përkatësisht 21 dhe 20 vjeç. Kjo pasi në mjetin e tyre u gjetën dhe sekuestruan 85 pako me 85 kg 915 gram marijuanë. Prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadha, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitiloakarnania, Kostur, Grevena, Follorinë, Aleksandroupoli, policia greke ka sekuestruar rreth 7.9 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.



### Kërkohej në Belgjikë për trafik droge, arrestohet në Morinë 31-vjeçari nga Kosova

Një 31-vjeçar kosovar është arrestuar ditën e djeshme në pikën kufitare të Morinës pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Belgjika për trafik droge. Shërbimet e Stacionit të Policisë Kufitare në Morinë në hyrje bënë ndalimin e shtetasit kosovar Valdrin Nikqi, 31 vjeç, banues në fshatin Neberganj, Kosovë. Ky shtetas u ndalua pasi nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi person në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Belgjikë. Gjykata e Shkallës së Parë Bruges-Belgjikë, më datë 25.11.2016, e ka dënuar 2 vite e 6 muaj burg për veprën penale "Pjesëmarrje në grup kriminal me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike", parashikuar nga Kodi Penal Belg. Në përfundim të veprimeve hetimore Specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve në DVP Kukës, bënë arrestimin provizor të tij, me qëllim ekstradimin në shtetin Belg, si dhe referuan materialet për veprime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Permbaruesi Gjyqesor Privat Çezar Beja

Permbaruesi Gjyqesor Privat Çezar Beja me adrese Lagja Nr 2, Rruga "A.Goga", Qendra "Eden" Kt 3, Durres, Tel 0674053771, email cezarbeja@hotmail.com
Shpall ankandin e dyte per pasurite e paluajteshme te debitorit Hysni Vath Gjergji, Suzana Rrahman Gjergji, Rajl Hysni Gjergji
1.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 9/4, ZK 3137, Vol 4, Fq 78, Sip 2950m2, Adresa Rade, Njesia Admininistrative Manez, Bashkia Durres
**Çmimi ne ankandin e dyte eshte 2.534.400 leke**
2.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 82, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njesia Admininistrative Manez, Bashkia Durres
**Çmimi ne ankandin e dyte eshte 4.316.400 leke**
**Ankandi do te zhvillohet ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat Çezar Beja ne daten 20.09.2018 duke u mbyllur ne oren 16.00**

**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

*-"Apartament", me sip. 69.2 m2, Nr pasurie 10/158+2-1, Z. K 8631, vol. 9, fq 80, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1 Lezhe. Prona eshte e regjistruar prane Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Lulzim Kros Beqiri . Çmimi i ri per shitje eshte 2.170.000 Leke.*
*Data e shpalljes 06.08.2018*
*Data e zhvillimit 11.09.2018 deri ne oren 16.00*

***Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.***

**Njoftim për shitje me ankand**

**Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezanesin K S te ndodhura ne fshatin Panahore. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :
"Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me siperfaqe 2500 m2 ZK 2869 me cmim 1.200.000 lekë
"Pasuria "Are" nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmim prej 80.000 lekë
"Pasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me çmimin në masën 400.665 lekë
**Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet dt 13.09.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 672082543, e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com**

PRANIMET NE UNIVERSITETE

INTERVISTA

Rektorja e UAMD-së: Programet 2-vjeçare profesionale, ndër të parapëlqyerat

# Regjistrimi, universiteti i Durrësit plotëson rreth 50% të kuotave

## Kseanela Sotirofski: 955 të regjistruar për 6 ditë

Voltiza Duro

*Ditën e sotme nis faza e katërt e raundit të parë të regjistrimeve për të gjithë maturantët që do të vijojnë rrugëtimin akademik në një prej Institucioneve Arsimore të Arsimit të Lartë në vend. Edhe në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, interesi nga ana e të rinjve ka qenë i lartë, ku vetëm në 6 ditë janë regjistruar 955 studentë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", rektorja e UAMD-së, Kseanela Sotirofski tregon se rreth 50% e kuotave të vëna në dispozicion për studentët e vitit të parë janë plotësuar që në 3 fazat e raundit të parë. Më tej, rektorja bën me dije se një interes të veçantë maturantët kanë shfaqur edhe për programet e Fakultetit të Studimeve Profesionale, i cili ofron programe dyvjeçare, që i orientojnë të rinjtë drejt profesionit. Gjithashtu, Sotirofski bën me dije se edhe Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike me degë si Drejtësia, por edhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ka qenë i preferuar nga maturantët e këtij viti. Ndërkohë, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën diferencohet vetvetiu nga vetë fakti që është themeluar sipas një modeli gjerman dhe në fund të trevjeçarit studentëve të tij iu jepet diploma, por edhe kontrata e punës në dorë.*



Rektorja e UAMD-së, Kseanela Sotirofski

**Sa është numri i aplikimeve në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës për vitin e ri akademik 2018-2019?**

Për vitin akademik 2018-2019 për të studiuar në programet e nivelit të parë Bachelor në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës ka pasur më shumë se 25 mijë aplikime. Shpërndarja e tyre ka qenë pothuajse e njëjta në të gjashtë fakultetet. Kjo shifër tregon që interesi i maturantëve për të studiuar në universitetin e Durrësit është shumë i lartë.

**Cilat janë disa prej programeve më të parapëlqyera nga maturantët këtë vit?**

Mund të them se ndër programet më të kërkuara janë ato të Fakultetit të Studimeve Profesionale, i cili ofron programe dyvjeçare që orientojnë të rinjtë drejt profesionit. Kemi vërejtur që interes të madh ka pasur edhe në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike në degë si Drejtësia, por edhe në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. Fakulteti i Biznesit ka qenë përherë një pikë e fortë e UAMD-së. Ndërsa Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën diferencohet vetvetiu nga vetë fakti që është themeluar sipas një modeli gjerman dhe në fund të trevjeçarit studentëve të tij u jepet diploma, por edhe kontrata e punës në dorë. Pra siç mund ta kuptoni, Universiteti i Durrësit tashmë është i konsoliduar në të gjitha fakultetet dhe jo më kot është universiteti i dytë më i madh në vend.

**Sa është numri i studentëve që janë regjistruar në një prej programeve të studimit në UAMD në 3 fazat e para të raundit të parë?**

Deri më tani janë regjistruar 955 studentë në një prej programeve të studimit ku janë shpallur fitues. Vlen të theksoj se në këto 3 faza të raundit të parë janë plotësuar rreth 50% të kuotave që janë në dispozicion për vitin e parë akademik.

**Ku duhet të bëjnë kujdes maturantët gjatë raundit të parë?**

Maturantët duhet të jenë të vëmendshëm dhe të verifikojnë në kohë reale në portalin "U-Albania" renditjen e pikëve, klasifikimin dhe lirimin e hapësirave në degët që dëshirojnë. Në rastin kur dega ose degët shfaqen me ngjyrë të gjelbër, maturanti është fitues; kur shfaqen me ngjyrë të verdhë është një sinjalizim që tregon se kandidati është fitues për shkak të lirimit të kuotave, por që ende duhet pritur për përditësimin e listës. Vetëm në momentin që degët me ngjyrë të verdhë të kthehen me ngjyrë të gjelbër, maturantët që rezultojnë fitues duhet të paraqiten pranë sekretarive tona mësimore me dokumentacionin e duhur për t'u regjistruar. Po ashtu, do të këshilloja maturantët që për çdo pyetje apo paqartësi të na drejtohen në uebfaqen zyrtare të universitetit, www.uamd.edu.al, si dhe në rrjetet sociale.

**Sa është numri i ankimimeve që kanë bërë maturantët?**

Deri në këto momente nuk kemi pasur asnjë ankimim nga maturantët në lidhje me programet e studimit që kanë aplikuar pranë universitetit "Aleksandër Moisiu".

**Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin fituesit pranë sekretarive mësimore për t'u regjistruar në një program studimi?**

Dokumentacioni për t'u regjistruar si student i vitit të parë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës përfshin fotokopjen e një mjeti identifikimi, fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së mesme ose diplomë tjetër studimi e njehsuar nga MASR. Gjithashtu, fituesit duhet të paraqesin pranë sekretarive mësimore të fakulteteve ku janë shpallur fitues edhe deklaratën e paraqitur në shtojcën 1 (plotësohet në sekretarinë mësimore); si dhe një mandat arkëtimi për tarifë regjistrimi. Për të lehtësuar procesin tarifën e regjistrimit e kemi ngarkuar në uebfaqen zyrtare.

**Meqë jemi ende në raundin e parë të regjistrimeve, përse maturantët duhet të zgjedhin universitetin tuaj?**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" është universitet dinamik dhe me rritje të qëndrueshme. Kur u hap 12 vjet më parë kishim një universitet me pak më shumë se 500 studentë, ndërsa vitin e fundit në të parë regjistrimin e studimit në UAMD kemi pasur 20 mijë të tillë. Mesatarja hyrëse e aplikantëve për vitin e kaluar akademik ishte mbi 8, tregues edhe i rritjes cilësore të UAMD-së. Jemi universitet që u kushtojmë rëndësi të madhe shërbimeve ndaj studentit. Po ashtu, studentët tanë kanë fatin e mirë të mund të studiojnë për një semestër apo për një vit në universitete perëndimore si pjesë e programeve të shkëmbimit që kemi me universitete në mbarë Europën. Ata janë të orientuar drejt tregut të punës përmes praktikave profesionale të garantuara nga Universiteti. Mandej, ne kemi privilegjin e një kampusi universitar modern, që nuk e ka asnjë universitet në Shqipëri. Me stafin akademik, ndërkombëtarizimin, por edhe shërbimet dhe anën infrastrukturore, studentët do të zgjedhin një ndër universitetet që ka bërë hapat më të mëdhenj përpara në arsimin e lartë në vend.

### VERIFIKIMI I FITUESVE

Në rastin kur dega ose degët shfaqen me ngjyrë të gjelbër, maturanti është fitues; kur shfaqen me ngjyrë të verdhë është një sinjalizim që tregon se kandidati është fitues për shkak të lirimit të kuotave, por që ende duhet pritur për përditësimin e listës. Vetëm në momentin që degët me ngjyrë të verdhë të kthehen me ngjyrë të gjelbër, maturantët që rezultojnë fitues duhet të paraqiten për t'u regjistruar.

### VITI AKADEMIK

Për vitin akademik 2018-2019 për të studiuar në programet e nivelit të parë Bachelor në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës ka pasur më shumë se 25 mijë aplikime. Shpërndarja e tyre ka qenë pothuajse e njëjta në të gjashtë fakultetet. Kjo shifër tregon që interesi i maturantëve për të studiuar në universitetin e Durrësit është shumë i lartë.

### DOKUMENTACIONI

**Dokumentacioni për t'u regjistruar si student i vitit të parë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës përfshin:**

- Fotokopjen e një mjeti identifikimi.
- Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së mesme ose diplomë tjetër studimi e njehsuar nga MASR.
- Deklaratën e paraqitur në shtojcën 1 (plotësohet në sekretarinë mësimore.
- Mandat arkëtimi për tarifë regjistrimi.

### REGJISTRIMET

"Deri më tani janë regjistruar 955 studentë në një prej programeve të studimit ku janë shpallur fitues. Vlen të theksoj se në këto 3 faza të raundit të parë janë plotësuar rreth 50% të kuotave që janë në dispozicion për vitin e parë akademik.

### Edi Rama: Kujdes, mos i dëmtoni librat!

# Nis shpërndarja e teksteve falas për 190 mijë nxënës nga klasa I-IV



**REFORMA**
Ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla ka prezantuar tekstet e reja për 400 mijë nxënës që do fillojnë vitin e ri mësimor në sistemin parauniversitar. Sipas ministres, reforma e alterteksteve me 1310 tekste, deri në 11 alternativa për një lëndë, ka sjellë shumë ankesa.

Dje ka nisur shpërndarja e teksteve falas për rreth 190 mijë nxënës nga klasa e parë deri në të katërt për sistemin parauniversitar. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministrja e Arsimit Lindita Nikolla kërkoi nga fëmijët që përfitojnë këto tekste falas që të tregohen të kujdesshëm dhe të mos i dëmtojnë për të kaluar kështu edhe te brezat e tjerë. Ndërkohë ministrja e Arsimit Lindita Nikolla ka prezantuar tekstet e reja për 400 mijë nxënës që do fillojnë vitin e ri mësimor në sistemin parauniversitar. Sipas ministres reforma e alterteksteve me 1310 tekste, deri në 11 alternativa për një lëndë, ka sjellë shumë ankesa. "Alterteksti prodhoi 1310 tekste, një kaos i vërtetë, korrupsion dhe gabime të panumërta në sistemin tonë arsimor. Tekste që ishin në duart e fëmijëve tanë duke kapur dhe numrin e 11 alternativave për një lëndë. Mësuesit, prindërit denonconin gabimet. Nxënësit ankoheshin për mbingarkesën dhe moskuptimin e atyre që lexonin. Media po ashtu denonconin kaosin, por nuk kishte as vesh për të dëgjuar, as sy për të parë dhe as zemër për të vepruar për ata që janë drita e syrit e çdo familje shqiptare, fëmijët",- shprehet Nikolla. Ndërkaq kjo e fundit thekson se tekstet sot janë të standardeve ndërkombëtare. Ajo sqaron më tej se para se tekstet të futen në katalog dhe të licencohen, kalojnë vitin e provës pothuajse 9 muaj të plotë nga mësuesit e Shqipërisë, të cilët pyeten sërish për të parë nëse ka kaluar diku ndonjë gabim i vogël dhe që kthehet në detyrim për t'u respektuar nga botuesit në mënyrë që teksti të jetë përfundimisht i licencuar dhe i futur në katalogun e teksteve. "Është një ndryshim i madh, sepse vëmendja e kësaj qeverie është tërësisht tek fëmijët, tekstet, që zgjidheshin përmes korrupsionit dhe në konflikt të pastër interesi, padyshim nuk bën atë që është motivi kryesor i shkollës, edukimi dhe cilësia e dijes për t'u përshtatur nesër si qytetar të suksesshëm në një shoqëri që integrohet në Bashkimin Evropian",-thotë Nikolla.

### Rektori i Universitetit të Mjekësisë: Besoj se kuotat do të plotësohen në raundin e parë

# Plot 220 regjistrime në Mjekësinë e Përgjithshme, ngelin bosh 40 vende

## *Arben Gjata: Interes edhe për Stomatologjinë e Farmacinë*

Voltiza Duro

Programet e studimit në Universitetin e Mjekësisë vazhdojnë të mbeten ndër më të preferuarat për maturantët. Brenda 3 fazave të raundit të parë në degën Mjekësi e Përgjithshme janë regjistruar rreth 220 studentë, nga 260 kuota të vëna në dispozicion për këtë program. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", rektori i këtij universiteti, Arben Gjata tregon se Mjekësinë e përgjithshme ka rreth 40 kuota të lira. "Deri më tani numri i studentëve që janë regjistruar në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme ka arritur rreth 220. Ndërkohë, numri i kuotave që ne kemi në dispozicion për këtë degë është 260. Besoj se brenda raundit të parë, pra deri në 12 shtator do të jenë plotësuar të gjitha kuotat për këtë degë", - tregon Gjata për 'GSH'. Por edhe programet e studimit si Stomatologji apo Farmaci me 100 kuota në total për secilën, kanë pasur një numër të lartë regjistrimesh në këto 6 ditët e fundit. "Edhe dega e Stomatologjisë dhe ajo e Farmacisë janë tejet të parapëlqyera nga të rinjtë. Numri i regjistrimeve në këto programe studimi në 3 fazat e raundit të parë ka qenë i lartë", - bën me dije rektori i Universitetit të Mjekësisë.

**KUOTAT**

Universiteti i Mjekësisë në Tiranë ofron 12 programe studimi për të gjithë të rinjtë që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta në një prej këtyre degëve. Numri i kuotave të vëna në dispozicion për të 12 degët në total është 1040. Maturantët që kanë aplikuar në këto programe studimi mund të verifikojnë në kohë reale (nëpërmjet ID përkatëse), në portalin "U-Albania" numrin e pikëve të grumbulluara që ndryshojnë nga njëri program studimi në tjetrin, në bazë të kritereve të përcaktuara. Respektivisht këtë vit në Universitetin e Mjekësisë do të pranohen 240 studentë në Infermieri si dhe 50 studentë të rinj në vitin e parë Bachelor për Fizioterapi. Programi i studimit Teknik Imazherie ofron për vitin e ri akademik 2018-2019 plot 50 kuota e të njëjtin numër kuotash ofron edhe dega Teknik Laboratori. Ndërkohë ky universitet ofron edhe këto programe studimi: Shëndet Publik, Mami, Higjienist Dentar, Teknik Dentar e Logopedi. Regjistrimi i fituesve në raundin e parë ka filluar në 30 gusht e do të vijojë deri në 12 shtator, por kandidatët për universitete kanë të drejtë që në 13 shtator të çregjistrohen nga programi i studimit ku janë regjistruar dhe të riaplikojnë në raundin e dytë. Çdo raund do të përbëhet nga 7 faza 48-orëshe secila e gjatë kësaj kohe maturantët fitues duhet të ndjekin me kujdes lëvizjen e vijës së kuqe.



Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Arben Gjata

**REGJISTRIMET**
"Edhe dega e Stomatologjisë dhe ajo e Farmacisë janë tejet të parapëlqyera nga të rinjtë. Numri i regjistrimeve në këto programe studimi në 3 fazat e raundit të parë ka qenë i lartë", - bën me dije rektori i Universitetit të Mjekësisë.

**220**
**TË REGJISTRUAR NË MJEKËSI**
"Deri më tani numri i studentëve që janë regjistruar në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme ka arritur rreth 220. Ndërkohë, numri i kuotave që ne kemi në dispozicion për këtë degë është 260. Besoj se brenda raundit të parë, pra deri në 12 shtator do të jenë plotësuar të gjitha kuotat për këtë degë", - tregon Gjata për 'GSH'.

**1040**
**KUOTA NË TOTAL PËR UM**
Numri i kuotave të vëna në dispozicion për të 12 degët në total është 1040. Maturantët që kanë aplikuar në këto programe studimi mund të verifikojnë në kohë reale (nëpërmjet ID përkatëse), në portalin "U-Albania" numrin e pikëve të grumbulluara që ndryshojnë nga njëri program studimi në tjetrin, në bazë të kritereve të përcaktuara.

**240**
**STUDENTË NË INFERMIERI**
Respektivisht këtë vit në Universitetin e Mjekësisë do të pranohen 240 studentë në Infermieri si dhe 50 studentë të rinj në vitin e parë Bachelor për Fizioterapi. Programi i studimit Teknik Imazherie ofron për vitin e ri akademik 2018-2019 plot 50 kuota e të njëjtin numër kuotash ofron edhe dega Teknik Laboratori.



## Bashkia e Tiranës, Aksion i gjerë për pastrimin e mbetjeve

Bashkia e Tiranës po zhvillon një aksion të gjerë pastrimi në të 24 njësitë administrative të kryeqytetit si dhe në rrugët kryesore duke hequr inertet. Gjithashtu po bëhet edhe pastrimi i mbetjeve të hedhura pa kujdes nga qytetarët që sjellin jo vetëm ndotje, por shkaktojnë edhe probleme. Punonjësit e ndërmarrjes Nr 1 të Bashkisë po vijojnë punën duke u kujdesur çdo ditë për imazhin e Tiranës përmes pastrimit dhe mirëmbajtjes. Përmes këtij aksioni të gjerë pastrimi nga mbetjet, Bashkia e Tiranës i paraprin edhe stinës së vjeshtës.



## Bllokohet lokali në Peshkopi, ambiente me myk e lagështi

Ditën e djeshme është bërë bllokimi i aktivitetit të një lokali që organizonte dasma në Peshkopi. Pas kontrolleve të ushtruara nga AKU, u konstatua se në këtë restorant mungonin kushtet higjieno-sanitare. Po ashtu ndaj biznesit u mor edhe masa administrative me gjobë me vlerën 300.000 lekë. Konkretisht, gjatë kontrollit që AKU ushtroi në subjektin "Drita Markja" Shupenzë, Peshkopi u konstatuan ambiente me myk, lagështi si dhe mjetet e punës në kuzhinë ishin totalisht të amortizuara. Ndaj subjektit u mor masë administrative gjobë me vlerën 300.000 lekë si dhe masa bllokim i menjëhershëm i aktivitetit.

### Deputeti ndihet keq në parlament, dërgohet me urgjencë në spital

# Haradinaj paraqet negociatorët e dialogut me Serbinë

## Opozita bojkoton seancën e jashtëzakonshme në Kuvend

Sipas lajmërimit të kreut të Kuvendit, Kadri Veseli, dje u mbajt seanca e jashtëzakonshme në Kuvendin e Kosovës. Seanca u realizua pas kërkesës së kryeministrit Ramush Haradinaj, në lidhje propozimin e qeverisë së Kosovës për emërimin e ekipit negociator për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Seanca e njoftuar për në 10:00, nisi me një orë e gjysmë vonesë, ndërsa opozita kosovare ka bojkotuar sallën. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, hapi seancën dhe njoftoi se në sallë ishin 61 deputetë. Por vetëm pas disa orësh punime, seanca u ndërpre, për të rifilluar në orën 16:30. Ndërkaq kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj prezantoi emrat e ekipit negociues për dialogun me Serbinë. Ai tregoi se në këtë ekip kanë vende të rezervuara edhe partitë opozitare dhe shoqëria civile. Haradinaj ka cituar edhe njëherë pjesëmarrësit në ekipin negociator, duke filluar me kryesuesin, Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj zëvendëskryesues, dhe anëtarët Behgjet Pacolli, Dardan Gashi, Avni Arifi dhe Mahir Jagxhilar. Ndërsa mbeten për t'u plotësuar emrat nga radhët e LDK, Vetëvendosje, PSD, Alternativa dhe shoqëria civile. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandar Vuçiç do të zhvillojnë raundin e ri të bisedimeve më 7 shtator. Të dy presidentët, kohët e fundit kanë folur për mundësinë e korrigjimit të kufirit mes dy shteteve, e cila, sipas presidentit Thaçi, mund të jetë pjesë e marrëveshjes eventuale të paqes mes Prishtinës dhe Beogradit. Thaçi është zotuar se në dialog do të flasë edhe për mundësinë e bashkëngjitjes së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën. Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Bashkimi Evropian pret që në fund të këtij procesi të dyja shtetet të arrijnë marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve, e cila veç tjerash, ua hap perspektivën evropiane të dyja shteteve. Një tjetër element që ka tërhequr vëmendjen ditën e djeshme ka qenë fakti se një deputet i Kosovës është dërguar në spital sapo ka arritur në Kuvend ku po zhvillohej seanca e jashtëzakonshme. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka njoftuar të gjithë të pranishmin në sallën e Kuvendit të Kosovës, se njëri prej deputetëve është dërguar për në spital, por nuk e ka thënë emrin. "Një deputet është sëmurë, nuk dua ta bëj emrin publik, mirëpo ai është shoqëruar për në spital", ka thënë kreu i Kuvendit, raporton Express. Pas bojkotimit të seancës nga opozita, deputetja e vetme që qëndroi në sallë ishte Teuta Rugova e LDK-së. Kjo seancë e qeverisë u thirr një orë më herët se seanca e opozitës, ku do miratohej një rezolutë që i ndalon Thaçit të diskutojë për territorin në dialogun e Brukselit.



**GRUPI NEGOCIATOR**

Fatmir Limaj
**kryesues**
Enver Hoxha
zëvendës/kryesues
Behgjet Pacolli
**anëtar**
Dardan Gashi anëtar
Mahir Jagxhilar
**anëtar**
Avni Arifi anëtar

### Ivica Daçiç, propozon një 'Dayton 2'

## Ndryshimi i kufijve të Kosovës? Johannes Hahn: Zgjidhja duhet t'i kontribuojë rajonit

Johannes Hahn, Komisioneri për Zgjerim i Bashkimit Evropian, se përjashtoi mundësinë e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis dy vendeve duhet të kontribuojë në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e rajonit. "Jam në favor të zgjidhjes së çdo konflikti dypalësh dhe çdo zgjidhje duhet të kontribuojë në një stabilitet më të gjerë në rajon",-tha Hahn në një deklaratë për Radion 'Evropa e Lirë'. I pyetur nëse ndryshimi i mundshëm i kufijve mund të ndikojë Bosnjën, Maqedoninë apo vendet e Partneritetit Lindor, Hahn tha se është herët të flitet për këtë çështje. "(Palët) po negociojnë ende. Le të themi, disa ide janë shfaqur. Mendoj se një marrëveshje ligjërisht e obligueshme midis Serbisë dhe Kosovës duhet të përfshijë shumë elemente. Mendoj se të dyja palët janë tani të vetëdijshme, nuk do të thosha për shqetësimet ndërkombëtare, por për kufizimet dhe, brenda tyre, shumë zgjidhje janë të mundshme",-tha Hahn. Ideja për ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë është shpalosur nga presidentët e dy vendeve, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiç, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre dhe ajo ka ngjallur reagime për dhe kundër. Ndërsa ministri i Jashtëm serb Ivica Daçiç tha se një zgjidhje për "nyjën e Kosovës" mund të vijë përmes organizimit të një konference ndërkombëtare. "Si parakusht për një gjë të tillë do të ishte që qëndrimet e të dy palëve të përafroheshin, meqë, sikundër dihet, janë ende larg njëri-tjetrit" – deklaroi Daçiç për mediat serbe. Referuar deklaratave të ministrit Daçiç, mediat në Serbi shkruajnë se organizimi i një konference ndërkombëtare për zgjidhjen e problemit të kufirit mes Kosovës e Serbisë, mund të quhet një 'Dayton 2', konferencë, e cila do të mbahet në para muajit maj 2019. Kreu i diplomacisë serbe tha se korrigjimi i kufijve do të ishte çështja e vetme e kufijve në axhendë në rastin e një 'Dayton 2'.

### Eksperti gjerman për Ballkanin: Këmbimi territoresh, hapi i parë drejt Shqipërisë së madhe

## Amerika është tërhequr, çështja në dorë të BE-së.

Nëse fillon loja e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë, kjo nuk do të përfundojë këtu, thekson në intervistë me 'Deutsche Wellen', eksperti i shoqatës gjermane, DGAP për 'Deutsche Wellen'.

Thaçi dhe Vuçiçi po planifikojnë të këmbejnë territore. Uashingtoni nuk është kundër. Pas bisedës me Donald Trump, Kancelarja Merkel nuk ishte aq e njëkuptimtë në deklaratën e saj, sikurse më parë. Edhe Heiko Maas, ministri i Jashtëm i Gjermanisë, në kuadër të takimit joformal në Gymnich tha vetëm se nuk ishte ide e mirë të ndryshoheshin kufijtë. Kjo tingëllonte më shumë si këshillë se sa si refuzim. Mos është Gjermania duke e zbutur qëndrimin e saj lidhur me kufijtë në Ballkan?

Nuk do të shikoja patjetër nuancat. Qëndrimi i Berlinit është më se i qartë. Gjermania ka qenë gjithmonë konsekuente dhe shumë e qartë lidhur me këtë çështje. Së pari, pas dyerve të mbyllura, gjatë takimeve të Kancelares Merkel në Berlin me presidentin Vuçiç dhe presidentin Thaçi, dhe më pas me kryeministrin e Bosnjës. Ajo e ka folur këtë edhe me kryeministrin kroat Plenkoviç.



Ndoshta nuk ka dashur t'i hedhë benzinë zjarrit duke bërë edhe një deklaratë tjetër, pas asaj të gushtit 2013. Por unë nuk shoh asnjë ndryshim te qëndrimi i Gjermanisë. Janë të tjerë ata që kanë ndryshuar. Për kë e keni fjalën? Uashingtoni po se po. Deklarata e John Bolton për mendimin tim është një shenjë se amerikanët po shohin për alternativa, meqë nuk janë më të interesuar. Ata nuk e shohin rolin e Amerikës si udhëheqës. Ky është për ta një problem që i mbetet Europës. Por ky nuk ishte qëndrimi i unifikuar i BE-së. Ata thjesht prezantuan vijën diplomatike të Austrisë e jo atë të presidencës. Përse Thaçi dhe Vuçiçi sollën propozimin e ndryshimit të kufijve? Kur presidenti Thaçi ishte për vizitë në Berlin, ne e kishim të ftuar në DGAP së bashku me ambasadorin Ischinger, dhe Thaçi atëherë e përjashtoi qartë mundësinë e ndryshimit të kufijve. Ishte një gjë e mirë që e tha publikisht, por tani gjërat kanë ndryshuar dhe unë nuk e di se përse. Nga pala serbe është e qartë, se për ta ky ka qenë gjithnjë një opsion, qysh prej vitit 1999. Dhe tani presidenti Vuçiç thotë se njohjen e Kosovës mund ta justifikojë para opinionit publik duke marrë diçka si kompensim, pra, territor.

**A është ky opsion realist?**

Është realist nëse liderët vendas janë të vendosur ta realizojnë dhe aktorët kyçë të jashtëm, fuqitë e mëdha, do ta lejojnë. Por unë jam pak i shqetësuar se kjo histori nuk do të mbarojë me kaq.

**Cili do të jetë efekti i saj?** Nuk është puna te korrigjimi i kufijve. Unë besoj se është një çështje komplekse. Është iluzion të mendosh se do të kemi vetëm një këmbim të vogël territoresh. Është e kuptueshme që është shumë tërheqëse në këtë pjesë të vogël të Ballkanit, kur kemi parasysh Kosovën e Veriut dhe Preshevën, por nuk do të mbarojë aty.

“BIMA E PËRJETËSISË” ËSHTË SHPËTIMI MË I MIRË NGA PASOJAT E DIELLIT


# SUMMER pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E mërkurë 5 Shtator 2018




“MIRË QË KE B*TH, SE TRU KE MUNGESË TË THEKSUAR”, FANSAT I ‘SULEN’ KEQ KEJVINËS



Eva pozon me bikini, nusja e Topallit të lë pafjalë

BULEVARDI POLITIK



- Rama i refuzon glikonë familjes, zonja e shtëpisë: Jeni shumë kokëfortë
- Vajza e Jozefina Topallit ndjek gjurmët e së ëmës? Takon Prodin në konferencë
- Takime të përzemërta mes deputetëve të maxhorancës në sezonin e ri parlamentar
- Xhaka kërkon falje për festimin me shqiponjë, Shaqiri ironizon: Duke parë ndeshjen në male...



Jeta mes muzikës dhe familjes, pushimet përtej kufijve

# ANJEZA BRANKA:

## Unë në fakt i bëj të gjitha

*“Shqiptarët janë të përmalluar, mezi na presin në skenë”*

### Jeta mes muzikës dhe familjes, pushimet përtej kufijve

# ANJEZA BRANKA:

# Unë në fakt i bëj të gjitha

*"Shqiptarët janë të përmalluar, mezi na presin në skenë"*

Egla Xhemali

Pushime jashtë dhe brenda vendit. Kjo verë duhet të mbaj emrin e saj. Këngëtarja Anjeza Branka vjen në një rrëfim për "Summer pages" të "Gazeta shqiptare" për pushimet, muzikën, familjen si dhe për projektet e fundit. Bukuroshja e ka shijuar pafund këtë verë duke lëvizur kryesisht në Amerikë, por edhe në bregdetin shqiptar. Për të koncertet përtej kufijve kanë emocion të veçantë pasi shqiptarët janë të përmalluar për vendin. Sekreti i të qenit gjithmonë në formë është kujdesi me ushqimin si dhe palestra. Pasionin më të madh e ka për muzikën, pa të cilën nuk e imagjinon dot jetën. Për të të gjitha këngët janë të shtrenjta pasi në to gjendet një copëz e shpirtit. Branka është mjaft optimiste për tregun muzikor dhe prurjet e reja që kanë hyr në të. Këngëtarja pohon se ndihet mirë që bën pjesë në këtë treg. Thjeshtësia nuk del kurrë nga moda. Ajo ka zgjedhur të jetë natyrale në përditshmëri dhe të jetë e kuruar estetikisht kur është pjesë e eventeve të mëdha. Familja është gjithçkaja e saj dhe ajo ndihet e bekuar që i ka. Së fundmi, Anjeza na thotë se shumë shpejt do vij me një videoklip të ri dhe do të marri pjese tek "Kënga Magjike". Deri atëherë ne i urojmë suksese e sa më shumë arritje.





**Si shkoi vera për Anjezën? Ku i kalove pushimet?**
Vera ka kaluar jashtë mase mirë. Pushimet i kam kaluar dhe në Shqipëri dhe jashtë. Isha në Chicago, Nju Jork, Miami, Florida dhe Las Vegas pastaj erdha në Tiranë. Jam kënaqur jashtëzakonisht shumë. Kohët e fundit nuk kam lëzivur pasi jam marrë me projektin e ri, me klipin që shumë shpejt do dali. Tani mendoj të iki përsëri diku për dy javë pushime në Turqi.

**Më mirë koncertet brenda apo jashtë Shqipërisë?**
Koncertet edhe brenda dhe jashtë Shqipërisë janë të bukura, por me dallimin që jashtë merr më shumë emocion pasi shqiptarët janë të përmalluar. Mezi i presin këngëtarët, janë shumë të dashur. Normal që, dhe brenda vendit na duan, po jashtë pritja është shumë më e madhe se shqiptarëve u mungon vendi.

**A e sheh muzikën si profesion të përhershëm?**
Unë pa muzikë nuk kam jetë. Është pasioni më i madh që kam. Muzika është si puna e ujit, ajrit, frutit. Pasioni për të është aq i fuqishëm saqë më duket e pamundur ta kem larg vetes. Është si puna e binomit që nuk mund të ndahet pasi i prishet madhështia, çekuilibrohet ekuacioni. Muzika është gjithçka për mua.

Cilën nga këngët e tua e konsideron më të shtrenjtë?
Çdo këngë timen e kam bërë me shumë dashuri dhe kam punuar fort e për këtë arsye nuk mund të them cilën kam më të shtrenjtë. Nuk mund ti veçoj asnjërën nga ato. Më pëlqen çdo këngë pasi në to kam copëza të shpirtit. Ka njerëzit që kanë gusto të ndyshme. Njëri pëlqen një këngë, tjetri një këngë tjetër. Ti kthehem pyetjes që më kë bërë mësipër. Të gjitha këngët i kam të shtrenjta.





**Në çdo dalje tënden viheni re linjat perfekte. Si ia bën që je gjithmonë kaq në formë?**
Faktikisht unë merrem me palestër, po kohët e fundit të them të drejtën nuk e kam frekuentuar. Më shumë body code, që shkoj një herë në javë. Kam kujdes me ushqimin. Ha shëndetshëm, mundohem ti eleminoj yndyrnat, konsumoj shumë fruta, pij shumë ujë dhe lëviz. Çelsi i një trupi të bukur padyshim që është aktiviteti sportiv, lëvizja.

**Në përditshmëri preferon make up-in apo thjeshtësinë?**
Dikur jam lyer edhe kur shkoja të blija cigare ndërsa tani nuk është se e vras mendjen më. Më pëlqen më shumë thujeshtësia në përditshmëri. Pastaj kur kam ndonjë eveniment natyrisht që duhet të jem perfekte.

**Si është të jesh mami e famshme?**
Unë jam shumë e lumtur për gjithçka që kam. Pjesa e të famshmes nuk ka lidhje, pasi jam njeri i thjeshtë. Them se çdokush i gëzohet familjes që ka. Kështu bëj dhe unë jam e bekuar me djalin dhe familjen që kam. Ata për mua janë pasuria më e madhe, gjëja më e shtrenjtë.

**Çfarë amvise është Anjeza?**
Unë në fakt i bëj të gjitha. Nuk ka gjë që nuk e bëj. Jam e gjithanshme. (qesh)

**Si e sheh tregun muzikor në Shqipëri?**
Tregun muzikor në Shqipëri e lidh me kohën. Kështu para vitit 2006 unë kam qenë shumë aktive në tregun muzikor (le të themi e kam pasur unë atë), kurse tani kanë dal shumë këngëtarë të rinj që dhe vet më pëlejnë jashtë mase. Ndër vite e sidomos kohët e fundit tregu shqiptar ka ecur shumë. Unë ndihem mirë që jam pjesë e këtij tregu.

**Për çfarë nuk kursehesh?**
Nuk kursehem për atë gjë që më fiksohet, nuk e vras mendjen që të mendohem dy herë. O e marrë o ska! (qesh)

**Ke pasur ndonjë moment në skenë që e kujton si të vështirë?**
Sa herë që dal e kam emocionin dhe natyrisht që të jesh artsit duhet të kesh gjithmonë emocione. E vështirë është sa dal pastaj në momentin që jam në skenë jam në rregull. Skena të mbush me frymë, ty të ngelet që nëpërmjet performancës ta zotërosh atë.

**Projektet e fundit? Cilat do të jenë surprizat për publikun?**
Sa i përket projekteve kam dy. Një këngë, për të cilën është punuar fort dhe për dy javë do dali me videoklip si dhe mendoj se do marrë pjesë te "Kënga majike".

## ARGJENTINA RAMOSAJ VJEN ME POZA TË NXEHTA NGA PUSHIMET

Argjentina Ramosaj është një nga zërat më të bukur të tregut kombëtar. Por, bukuroshja pas angazhimeve të shumta në koncerte dhe projekte të reja, ka zgjedhur të shijoj rrezet e diellit. Ajo ka publikuar disa fotografi në llogarinë personale në 'Instagram', teksa shihet në krah të bashkëshortit dhe të birit. Argjentina në disa prej imazheve shfaqet tejet seksi e veshur në bikini të zeza dhe një fustan të shkurtër ngjyrë kafe dhe mban në duar një kapele. Theksojmë se dy muaj më parë biondina solli projektin "Sekreti", që erdhi si në bashkëpunim me DJ Geek. Ramosaj është duke punuar në projekte të reja muzikore që do t'i sjell gjatë muajve në vijim.





## "MIRË QË KE B*TH, SE TRU KE MUNGESË TË THEKSUAR", FANSAT I 'SULEN' KEQ KEJVINËS

Ajo është e njohur për postimet tejet provokuese. Bukuroshja e 'Xing me Ermalin' ka lënë përsëri pa fjalë me fotot e fundit. Ajo gjithmonë kujdeset që të nxjerrë në pah linjat e saj trupore. Por fansat e kanë sulmuar në këto imazhe me bikini. "Mirë që ke b*th, se tru ke mungesë të theksuar", i shkruan ai. Ndërkohë modeles nuk i ka kaluar ky koment dhe ka vendosur që t'i përgjigjet: "Shumë problem e kam këtë pjesë ke te drejtë. Po ti që je i zgjuar me sa pal tru komenton?" Jo rrallë herë Kejvina ka bllokuar komentet e ndjekësve.



## EVA POZON ME BIKINI, NUSJA E TOPALLIT TË LË PAFJALË

Shquhet për bukurinë klasike dhe natyrale që e karakterizon. Bëhet fjalë për prezantuesen shqiptare, Eva Murati, e cila është mjaft e komentuar si në rrjete sociale ashtu edhe media rozë. Ajo si shumë personazhe të njohura po e kalon fillimin e shtatorit në det, ndërsa nuk kursen me imazhe joshëse që ndan me fansat në "Instagram". Duke ekspozuar linjat bukuroshja shkruan: 'Me këto ritme postimi jam me foto vere deri ne dhjetor'.





## ME KË PO I KALON PUSHIMET KIDA?

Kida është një ndër vajzat më të komentuara të showbizit shqiptar. Mesa duket këngëtarja nuk i paska mbaruar akoma pushimet dhe këtë gjë na e vërtetoi me foton që ka postuar së fundmi në profilin e saj në 'Instagram', ku shfaqet bashkë më një mikeshën e saj duke pushur në ambientet e një pishine. Ariana Fejzullahu është personi me të cilën këngëtarja është duke shijuar ditët e relaksit. Gjithashtu, Ariana është një personazh mjaft i njohur për publikun shqiptar, ajo është bashkëshortja e këngëtarit të njohur Ermal Fejzullahu.









# Pa marrë parasysh tipin e flokëve dhe të lëkurës, "bima e përjetësisë" është shpëtimi më i mirë nga pasojat e diellit







Zgjidhja për lëkurën e thatë dhe flokët gjatë verës, djegiet dhe alergjitë nga dielli, metabolizmi i çrregullt në udhëtime dhe vështirësi të tjera të ndryshme, shumica zgjidhjen e kanë gjetur në aloe verën e famshme - zambaku i shkretëtirës.

Aloe vera është e pasur me materie ushqyese, që gjenden në fletët e tulta dhe në kërcellin e trashë që i thith të gjitha materiet nga ambienti.

Pikërisht për shkak të tendencës së thithjes, është me rëndësi të zgjedhim aloe verën e kultivuar organikisht, sepse kultivimi konvencional përmban pesticide, kimikate dhe plehra artificiale.

Duke shfrytëzuar ekskluzivisht aloe verën organike, i shmangemi kurthit të marrjes së pesticideve, konservanteve dhe herbicideve, OMGJ-së dhe përbërësve artificialë, që i dëmtojnë organet e brendshme dhe prishin ekuilibrin në organizëm.

Sipas hulumtimeve dhe këshillave të ekspertëve, aloe verën mund ta përdorni në shumë mënyra. Po i veçojmë katër veprime fantastike të saj:

**1. Shërimi i djegieve dhe i irritimit të lëkurës**

Aloe vera do të nxisë dhe përshpejtojë shërimin e djegieve të lëkurës të shkaktuara nga dielli, proceset inflamatore dhe irritimet (siç janë qimet e rritura pas depilimit dhe alergjia ndaj diellit dhe produkteve kozmetike).

Kur e lyeni lëkurën, do të krijojë shtresë mbrojtëse, e cila zvogëlon mundësinë e tharjes dhe të dëmtimit.

**2. Kurimi i lëkurës së kokës dhe hidratimi i flokëve**

Pas ekspozimit në diellin veror dhe ndaj kripës së detit që dinë të thajnë lëkurën e kokës dhe të dëmtojnë flokët, aloe vera do të kurojë nga maja e kokës deri te majat e flokëve.

Bëni masazh kokës me xhel aloe vere ose lëreni të qëndrojë si maskë në flokë për efekt të përtëritjes së qimeve dhe vëllimit.

**3. Buzëqeshje e kthjellët**

Shpëlarja e gavrës së veshit me lëng aloe vera do të reduktojë proceset inflamatore të mishit të dhëmbëve dhe do të ruajë higjienën dentale duke eliminuar kariesin.

Nëse dëshironi të keni buzëqeshje shkëlqyese gjithë verës, aloe vera do t'ju ndihmojë në këtë sfidë.

**4. Mbrojtje nga infeksionet dhe pickimet e insekteve**

Antioksidantët e fuqishëm (polifenolet) në aloe verën organike do t'i ndalin shtresat e ndryshme të baktereve, do t'i eliminojë kërpudhat dhe do të veprojë kundër viruseve. Mund ta përdorni si ndihmë të parë kundër sëmundjeve kërpudhore të lëkurës dhe thonjve dhe infeksioneve vagjinale, të cilat janë rezultat e shpeshtë i kohës së kaluar në pishina dhe plazhe.

Lyerja e xhelit në vendet e pickimit të insekteve (posaçërisht të mushkonjave), do të zbusë të kruarit dhe inflamacionin e lëkurës.

## Rama i refuzon glikonë familjes, zonja e shtëpisë: Jeni shumë kokëfortë

Kur na ndajnë edhe dy javë nga fillimi i vitit të ri shkollor, kryeministri Edi Rama ka vizituar familjen Karaj në Tiranë, ku u ka dhuruar librat Greisit dhe Reit. Gjatë bashkëbisedimit, kreu i qeverisë është ndalur tek disa nga momentet më kyçe të reformimit të sistemi arsimor, siç i quajti ai, duke përmendur edhe risitë e këtij viti, siç është një prej tyre ndalimi i celularit në shkolla. Në fund të këtij takimi, ku ndodhej i shoqëruar nga ministrja e Arsimit Lindita Nikolla dhe drejtoresha e shkollës "Ali Demi", Dorina Kuka, zonja e shtëpisë ka shpejtuar t'i qirasë me gliko mysafirët e saj.

Por pavarësisht insistimit të zonjës Karaj, kryeministri Rama nuk ka pranuar. "Insistojmë që ta provoni glikonë tonë, se jemi me origjinë nga Përmeti", u shpreh zonja Karaj. "Epo unë nuk jam nga Përmeti, dhe e kam kokën shumë të fortë", tha kryeministri Rama, duke u çuar në këmbë, e për t'u larguar. E teksa po i përcillnin mysafirët, zonja e shtëpisë nuk ngurroi t'ia përmendte edhe njëherë kryeministrit Rama "refuzimin" e glikosë, "Shumë të fortë e kishit kokën me gjithë mend".

"Po, shumë të fortë e kam kokën", ia pret kryeministri Rama.



## Vajza e Jozefina Topallit ndjek gjurmët e së ëmës? Takon Prodin në konferencë



Megi Topalli ka ndarë një foto speciale në rrjetet sociale. Vajza e Jozefina Topallit duket se po ndjek pasionin e madh të së ëmës, politikën. Ajo ka takuar ish- kryeministrin italian Romano Prodi gjatë një konference ku ka qenë pjesëmarrëse. Foton e ka shoqëruar edhe me elozhe për politikanin e dashur nga shqiptarët. "Sot në ditën e dytë të konferencës isha e nderuar të takoja një ndër europianistët më të mëdhenj të kohës. Përveçse një profesor i madh i ekonomisë, ish-kryeministër i Italisë, President i KE dhe mbështetës i vendit tim në procesin e integrimit"- shkruan Megi në "Facebook".

# BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

## Takime të përzemërta mes deputetëve të maxhorancës në sezonin e ri parlamentar



Me nisjen e sezonit të ri parlamentar, deputetët e mazhorancës zunë vendet e tyre në Kuvend dhe sigurisht nuk munguan edhe përshëndetjet me njëri-tjetrin, pas një periudhe (disi të shkurtër ) larg kolegëve, duke shijuar pushimet. Përveç përshëndetjeve të përzemërta, veshjet e grave të Partisë Socialiste ishin ato që i jepnin disi ngjyra parlamentit në këtë fillim sezoni.

## Xhaka kërkon falje për festimin me shqiponjë, Shaqiri ironizon: Duke parë ndeshjen në male...

Skuadra e Zvicrës u mblodh në hotelin Nati dhe dje, është dhënë edhe një konferencë për shtyp edhe trajneri Petkoviç. Ndërkohë që papritur në sallë hyjnë të gjithë lojtarët. Ndërsa për sa i përket qëllimit të këtij veprimi është për të krijuar transparencë për publikun. Ndërsa në konferencë për shtyp për ulet trajneri dhe këshilli i skuadrës me Stefan Lishtajner, Granti Xhakën, Jan Somer, Xherdan Shaqiri dhe Johan Zhuru. Dhe për herë të parë lojtarët kanë kërkuar falje për festimin me shqiponjë në Botëror. Xhaka tha: Do të isha budalla po ta bëja përsëri. Nuk do të ndodhë më. Stefan Litshtajner thotë: Kërkoj falje, nuk dua që t'i hap problem dikujt. Ndërsa Shaqiri me ironi thotë: Sigurisht, unë kërkoj falje nëse njerëzit u ndjenë të sulmuar, duke parë ndeshjen nëpër male..."



DEBATI

# "Të shkarkohen Çuli e Kumbaro, duam restaurimin e teatrove"

*"Kallëzim penal nga AMT për neglizhencë me pasoja të rënda në mosmirëmbajtjen e ndërtesës"*

*Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ashpërson gjuhën, nuk mjafton më kthimi i ligjit*

Fatmira Nikolli

Jo vetëm që nuk tërhiqen por kanë ashpërsuar gjuhën dhe kërkesat e tyre. Në një deklaratë të bërë publike dje, Aleanca për Mbrotjen e Teatrit pas 80 netësh protestë pa ndërprerje jo vetëm kërkon miratimin e dekretit të presidentit Meta që de fakto rrëzon ligjin që shemb teatrot, por kërkon me ngulm restaurimin e tyre dhe ndjekje penale për ata që i kanë lënë në rrënim.

Në një deklaratë me pesë pika, Aleanca mbërrin në kërkesa drastike pas injorimit më disa mujor që nisi në muajin shkurt dhe qëndroi edhe përgjatë verës në një rezistencë të papritur për shumëkënd. Të gjendur para faktit që ligji i kthyer nga presidenti po rikthehet për shqyrtim, e megjithë deklaratat amorfe politike, artistët e shoqëria civile që përbëjnë Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit, thotë se kërkon qeveria duhet të miratojë dekretin e presidentit dhe se "Përpjekjet për të testuar dhe lodhur artistët dhe qytetarët, duke e lënë të hapur për diskutime të mëvonshme dekretin, do dështojnë sërish". Më tej, në pikën dy të deklaratës, ata kërkojnë lirimin nga detyra të Drejtorit të Teatrit Kombëtar dhe Ministres së Kulturës e mandej, duan që qeveria të rihapë dy teatrot kombëtare aktuale për sezonin e ri artistik. Sipas tyre, yë ashtuquajtura "problemet infrastrukturore" të godinave janë lehtësisht të riparueshme dhe pjesë e një gënjeshtre të vazhdueshme publike që Drejtori i TK dhe Ministrja e Kulturës kanë përcjellë në publik.

Para disa ditësh Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit fotografoi një furgon pranë godinës së Teatrit Kombëtar dhe u shpreh se po mereshin prej aty objekte të TK-së për t'i dërguar te "Turbina", qendra e re artistike që po planifikohet të strehojë Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Teatrin Kombëtar të Operës dhe vetë skenën e pavarur.

Më poshtë deklarata e plotë.

**DEKLARATA E PLOTË**

Vendimi i djeshëm i mazhorancës parlamentare për të mos e përfshirë miratimin e dekretit të Presidentit për kthimin e "ligjit special për Teatrin" në kalendarin e punës së Kuvendit deri më 12 tetor, është një vendim i drejtë. Ai rikonfirmon edhe një herë sa problematik ka qenë ky ligj, shkeljet e tij të rënda, të cilat, pas një presioni në rritje, kanë detyruar tashmë Qeverinë të bëjë hapin e parë mbrapsht qëkur problemi u bë publik.

Me këtë rast duam të falënderojmë të gjithë ata qytetarë që nuk kanë reshtur së mbështeturi protestën tonë për të përditshme, gjatë gjithë ditëve të nxehta të verës. Prezenca e tyre e vazhdueshme tregon se një shoqëri që reagon, që organizohet dhe që lufton për një ideal, herët a vonë arrin të triumfojë.

Në mënyrë që tentativa për shembjen e Teatrit Kombëtar të eliminohet përfundimisht, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit (AMT) kërkon që:

1. Qeveria të miratojë dekretin në fjalë të Presidentit duke tërhequr përfundimisht nga kalendari "ligjin special". Ajo duhet të deklarohet publikisht pro restaurimit të dy teatrove kombëtare, me një proces të hapur, transparent, gjithëpërfshirës dhe me financim publik. Aleanca është e gatshme të diskutojë dhe propozojë modele të ndryshme financimi dhe menaxhimi për këtë qëllim, të aplikuar gjerësisht në ditët e sotme, duke përfshirë edhe donacione. Përpjekjet për të testuar dhe lodhur artistët dhe qytetarët, duke e lënë të hapur për diskutime të mëvonshme dekretin, do dështojnë sërish.

2. Lirimin nga detyra të Drejtorit të Teatrit Kombëtar dhe Ministres së Kulturës, tashmë të kallëzuar penalisht nga AMT, për neglizhencë me pasoja të rënda në mosmirëmbajtjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar, duke qenë se nuk kanë dhënë dorëheqjen deri tani.

3. Qeveria të parashikojë në buxhetin e vitit 2019, si edhe në plan-buxhetin afatmesëm, një buxhet për Ministrinë e Kulturës, të barabartë, ose më të madh, se sa ai i Ministrisë së Kulturës së Maqedonisë. Është e papranueshme që kultura shqiptare të vazhdojë të ketë një buxhet katër herë më të vogël se sa ajo e një vendi fqinj, me PPB dhe popullsi më të vogël se Shqipëria.




4. Kuvendi të marrë në shqyrtim nismat ligjore të propozuara nga Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit, si edhe Rrjeti "Skena e Pavarur Kulturore", për reformimin e plotë të sistemit teatror dhe sektorit jopublik të artit në Shqipëri.

5. Qeveria të rihapë dy teatrot kombëtare aktuale për sezonin e ri artistik. Të ashtuquajtura "problemet infrastrukturore" të godinave janë lehtësisht të riparueshme dhe pjesë e një gënjeshtër të vazhdueshme publike që Drejtori i TK dhe Ministrja e Kulturës kanë përcjellë në publik

Të nderuar qytetarë dhe media,

Çështja e Teatrit ka vënë në dukje probleme të mëdha të sistemit tonë politik dhe vendimmarrjes së tij. Është e qartë tashmë se një Parlament i zgjedhur nga lista të paracaktuara nuk ka asnjë mundësi reale për të mbrojtur qytetarët dhe për të limituar abuzimet e mundshme të Qeverive. Nevoja për një SISTEM të ri zgjedhor është urgjente për demokracinë dhe zhvillimin e shoqërisë tonë.

Nga ana tjetër, historia e Teatrit duhet të jetë edhe një shembull frymëzimi dhe trimërie për të gjitha shtresat dhe grupimet e tjera të shoqërisë të cilat duhet të ngrenë zërin për problemet e tyre. Fatmirësisht kjo shoqëri ka plot individë të aftë e pozitivë, që janë të gatshëm të ndihmojnë kauza të drejta. Ne e kemi ndjerë mbështetjen e tyre në çdo hap e jemi të sigurtë se kështu do të ndodhë dhe për grupime dhe raste të tjera.

Së fundmi, Aleanca mbetet në pritje të raportit përfundimtar të Komisionit Evropian mbi "ligjin special". Pavarësisht shtyrjes në Parlament, ai raport duhet ti konfirmojë përfundimisht opinionit publik çmendurinë ligjore dhe ekonomike që kishte marrë përsipër Qeveria shqiptare. Ai raport duhet të vlejë jo vetëm për të mbyllur përfundimisht këtë çështje, por edhe si parandalues për skema të ngjashme në të ardhmen.

Aleanca do vazhdojë të kthejë Sheshin e Teatrit në një hapësirë për artin dhe demokracinë edhe gjatë ditëve dhe javëve në vazhdim, derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e saj. Ai shesh ka qenë dhe do të mbetet një hapësirë e lirë, e hapur për këdo që kërkon të flasë, në një kohë kur kjo liri po na mohohet gjithmonë e më shumë. Jeni të mirëpritur çdo ditë, ashtu siç janë të mirëpritura dhe mediat të cilat shpresojmë se do jenë më të shumta në numër në ditët në vazhdim.

## ELIMINIMI I QENVE TË RRUGËS, ASGJË E RE NË TIRANË

**Në qytet janë shtuar qentë, autorizohet mbytja e tyre! Nuk bëhet fjalë për ditët e sotshme, por për vitin 1924. Siç duket, qentë pa zot kanë qenë shtuar aq sa, sipas Bashkisë së Tiranës, qenë kthyer në rrezik të shëndetit publik. Për eleminimin e tyre do të përdorej strihninë, një lloj pesticidi që rëndom përdoret për të luftuar brejtës. Sipas një njoftimi të po atij viti, lajmërohen zotëruesit e qenve shtëpiakë që t'i mbajnë ata lidhur, për të mos u eleminuar gabimisht. Foto: AQSh.**





FOTOLAJM

KRITIKA

Dekori e kishte zgjidhur hapësirën skenike në formën e një metafore: një tavolinë e stërgjatë që të kujtonte “Darkën e fundit” të Krishtit, por e kthyer përmbys dhe e pushtuar jo nga apostujt, por sahanlëpirësit dhe mediokrit.

# “VETËVRASËSI”

## Shfaqja që ndaloi Stalini, tallje e strukturave sociale

Nga Josif Papagjoni

*(vijon nga faqja 1)*

... me sfidën dhe rrezikun: tallja e një shoqërie që qysh në kryeherë e kishte mbushur trupin e vet me sloganet e rrejshme ideologjike, me retorikën dhe besimet e verbra në ndoca iluzione që shiteshin si doktrina të reja, si mite politike dhe fe e atrofizuar. Dhe vdekja kthehet në spektakël, në një show ku përfshihen të gjithë e të gjithë duan të nxjerrin përfitime prej saj. I ndëshkuari me vdekje a i vetëndëshkuari, një njeri i papunë, thuajse mjeran, i pafat, me emrin Simon, duhet të kaloj një kalvar që, në fakt, shndërrohet në karuzel ironie dhe përtalljeje, sa për atë vetë dhe pamundësinë e të qenit “i zoti”, aq dhe sidomos për qerthullin social që kërkojnë vdekjen e tij të pritshme, që e përlëvdojnë atë për “ide, interesa dhe qëllime të mëdha”, ndofta si një heroikë shterpe e sajuar nga ideologjitë shterpe, ku njeriu dhe jeta e tij shpërfillen, zgërlaqen. Dhe kështu, nën trysninë e ekzistencës së rrezikuar, të falimentit ekonomik, të papunësisë, të familjes, trysnisë së vjehrrës, grindjes së përnatshme me gruan, të komplekseve të inferioritetit, të pamundësisë së një perspektive e mungesës së dritës, i vetmi shpëtim është të dehet, të bëhet tapë, të harrojë. Atëbotë seriozja krejt bëhet qesharake, “qëllimet e mëdha” kinse fisnike me nevojën e “vetmohimit”, kthehen në një absurd tragjik, në një absurd ku të gjithë mbeten të tallur, ose të vetëtallur. Ky kontrapunkt i bukur krijon situatën komike. Simoni i strapacuar nga jeta dhe pamundësia dy herë shkon drejt vetëvrasjes - të imponuar apo të kërkuar nga ai vetë - dhe të dyja herët vetëvrasja shndërrohet në tallje për të tjerët: në rastin e parë përmes ëndrrës së tij, në rastin e dytë përmes dehjes dhe shpotisë kundër vetes e të gjithëve, në kërkim të një cope sallami më shumë. Por në rikonfirmim edhe të dashurisë ndaj gruas, të vetmes dhe të patjetërsueshmes, limanit ku ai mund të prehet e të gjejë paqen e munguar. Dhe kur plumbi i vetëvrasjes pritet të dalë prej revolverit, shfaqja mbyllet me një paradoks. Dëgjohet një krismë vetëvrasjeje, por jo e tij, është prej dikujt tjetri, e një gazetari të ri, mbase edhe më i parealizuar dhe më i stresuar se vetë Simoni. Vdekja, pra, ndodhi. Dhe në buzë ikën shakaja dhe mbërrin dhimbja…

Dola nga shfaqja “Vetëvrasësi” - një bashkëpunim i Teatrit “A. Z. Çajupi” të Korçës me Teatrin Kombëtar - dhe mendja më bridhte për të gjetur një pikë të fortë shpjeguese: pse nuk vritet ky njeri nga autori, por në vend të tij vritet një tjetër? Deri ku mbërrin loja, shakaja, spektakli mbi vdekjen si të tillë? Çfarë ulërin përtej shakasë, groteskut, kurdisjes së një situate komike thuajse në zgrip të farsës?! U konsultova me regjisorin Sulejman Rushiti dhe mëpastaj me “Google”. Autori Nikollaj Erdman, dramaturg dhe skenarist sovjetik, mik i regjisorit modernist të biomekanikës, të mirënjohurit Vsevollod Mayerholdit, e pat shkruar këtë komedi satirë, e konsideruar si kryevepra e tij, në vitin 1928. Shfaqja ishte ndaluar nga vetë Stalini dhe autori u internua në Siberi. Tallja që kishte realizuar Erdmani ndaj strukturave sociale e mentale të perandorisë sovjetike nën Stalinin kalonte përmes një stili brilant dhe satire të hollë që lëvizte, sipas kritikës, nga paradigmat e satirës së Gogolit drejt stilit të teatrit të absurdit, ku bëhen bashkë seriozja dhe qesharakja, dramatikja dhe burleskja, sublimja dhe e shëmtuara, e frikshmja dhe e këndshmja, ndryshe thënë “tmerri i bukur dhe bukuria e tmerrshme”. Pse? Sepse ka një vdekje që vallëzon gjithherë në veprimin dramatik, por ajo përherë deligjitomohet, kthehet nga drama, frikë dhe tmerr në shaka, lojë, grotesk (gallatë, hajgare).




Ja, ky ishte çelësi stilistik i veprës, që regjisori Sulejman Rushiti dhe gjithë ekipi i aktorëve u rrekën ta bëjnë pjesë të njëmendësimit të tyre skenik. Një qasje dhe stil tejet i vështirë, që të plas në dorë si një flluskë sapuni po nuk u trajtua me mprehtësi dhe delikatesë. Besoj se në të tërën e vet shfaqja e mbërriti atë. Por unë mbeta i dyshimtë se vallë a luhej me një seriozitet gati solemn e të pakundërshtueshëm vdekja e pritshme? Ky ishte kodi i veprës, çelësi i saj. Unë mendoj se kjo gjë herë bëhej mirë e herë ikte për duarsh. Loja e Neritan Liçajt si Simon ishte më pranë të vërtetës së këtij stili, ai e luante me një seriozitet të plotë situatën paradoksale ku ishte vendosur. Edhe Elia Zaharia në rolin e Mashës m'u duk pikërisht e tilla dhe së toku me Neritanin më ngjan se realizuan pjesën më të vështirë, por ama atë më thelboren e veprës dhe stilit të saj. Afrohet më pas edhe Zamira Kita si vjehrra, Serafima. Të tjerët, në vrapin dhe gjallërinë e veprimit, sekush në kërkim të një tipi e situate të veshur me burleskë e groteskë, shkonin e vinin rreth ngjarjes dhe situatave, por do të mendoja se do të lipsej, herë pas here, që të gjithë ata, aktorët-personazhe, të ishin shumë më “seriozë” dhe të “vërtetë” në ato çka bartnin, çka bënin dhe çka deklaronin. Vetëm kësaj udhe ironia dhe satira e tmerrshme do ta kthente paradoksalen e situatës, me vdekjen e përtallur, në një domethënie me nënkuptim tejet kritik për kohën, për iluzionet shterpe, diktaturat, për përpunimin dhe indoktrinimin ideologjik të njerëzve, më tutje për heroizmin fiktiv, religjionin e keqkuptuar, si dhe gjithë mjerimin që shtrihej këmbëve të njerëzve, gjer dhe për erotizmin si pjesë e “fundërrinave” të qytetit, për fitimet nga inskenimet e ngjarjeve kësilloj, për spektakularitetin bërtitës kur njeriu, varfëria dhe vdekja shndërroheshin në një “koncert”…



*Autori Nikollaj Erdman u internua në Siberi, pjesa shfaqet në KOKO-fest në Korçë*

Duke e mbajtur në tone të forta, me një energji të dallueshme interpretimi, sikundër pa e shkalafitur lojën në elemente farseske, nga ana tjetër mendoj se regjia në trajtimin e aktrimit, pra te spikamat ndaj domethënieve të ardhura prej tekstit dhe personazheve, mund të luante më mirë; ndofta me një temporitëm më fleksibël, ku të përvijoheshin herë pas here përthyerje, ulje-ngritje, një diagram e begatë përplot variacione intonative, diku me tone më të qeta, më intime, pa e mbajtur pra krejt shfaqjen në tone të larta zanore dhe me një energji, që ngjan se përkujdeset fort për ritmin e të folurit, por që krijonte sakaq edhe paralelizma, një vijë të drejtë, gjer dhe monotoni.

Aktrimi ishte, sikurse thashë, dinamik, plot gjallëri. Pos kësaj, aktorët sekush në rolin e vet krijuan individualitete, dhe do të kujtoja më tutje Albano Prodanin në rolin e një “horri” të kamufluar, Olta Gixhari me përpunimin plastik, Klodiana Keço që u dallua për fuqi dhe vërtetësi, Ilda Pepi sidomos për kërcimin energjik e plot hir mbi tavolinë, Ligoraq Riza për priftin e shastisur ca nga mosha, ca nga paratë e premtuara e ca nga zbehja e misionit të kishës, A. Tole ideologun kallp të komunizmit që edhe nga maska ngjasonte me Marksin, Mateus Froku për poetin patetik e gjer te gazetari që i jep fund vetes me një krismë, si Majakovski dikur, poeti i revolucionit por që u sfilit për dashurinë e parealizuar, dhe ia futi me një plumb kokës duke lënë si shpjegim një letër mallëngjyese. Dekori e kishte zgjidhur hapësirën skenike në formën e një metafore: një tavolinë e stërgjatë që të kujtonte “Darkën e fundit” të Krishtit, por e kthyer përmbys dhe e pushtuar jo nga apostujt, por sahanlëpirësit dhe mediokrit. Veçse unë do të dëshiroja më shumë dritë, hapësirë, lirshmëri, ku mizanskena të lëvizte me vrull poshtë e lartë e majtasdjathtas, pa u ngulur aq fort rreth a mbi atë tavolinë. Sepse komeditë kanë nevojë për ajër, dritë, gazmend, lëvizje. Shpesh mizanskenat janë kyçe e çelësa asilloj, ku krijohen edhe zgjidhjet e bukura regjisoriale, imazhet, ku krijohet ritmi, bukuria estetike, zhdërvjelltësia plastike.

Por si fjalë të fundit të këtij shënimi dua të them se shfaqja “Vetvrasësi”, përpos domethënieve të thukëta kundër çdo lloj thundre ndaj njeriut, përpos shpotisë dhe gjembit nën këmbë ndaj shoqërisë së viteve të komunizmit në Bashkimin Sovjetik, utopive të rrejshme, kotnisë, na solli edhe një qasje që troket në kohën dhe njeriun e sotëm shqiptar me varfërinë, atë njeriun e shpërfillur dhe të çpersonalizuar që e shohim kronikave televizive, dhe përmbi të gjithë gënjeshtrat, qaravitjet. Është një paralele që gjithkush mund ta heqë mbi shoqëritë e vetëmashtruara, të tredhura, lakmitare, që rrokopujen mes vrapit të çmendur të amoralitetit dhe talljes me njeriun e thjeshtë. Por s'i dihet: Njeriu i tallur dhe i thjeshtë mund të tallet bukur mirët me gjithë shoqërinë dhe idiotësitë e saj, duke ia bërë paq!...

Opinioni i Ditës

# Qyteti dhe siguria...!

Nga Përparim KABO

(vijon nga faqja 1)

... Një vlerësim i tillë përkthehet në një qytet me ambient urban social dhe publik ku territori është i kontrolluar nga organet e specializuara si edhe është policia e rendit, policia kriminale dhe organe ligjzbatuese të tjera të kësaj natyre, përfshi dhe policinë bashkiake. Qytet i sigurt ka atje ku qetësia publike është e pranishme. Jeta nuk është e rrezikuar, krimi ordiner është në nivele pothuaj joekzistuese ndërsa për krimin e organizuar as që edhe bëhet fjalë. Qytet i sigurt ka të bëjë me sigurimin e pronës dhe ky fakt është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me shtëpinë e qytetarit dhe objekte të tjera materiale si pasuri të patundshme, apo monedha, xhojleri, vepra arti, rroba të shtrenjta, automjete, mjete lundruese, etj. Mund të vijohet me numërimin e objekteve apo argumenteve. Krahas krimit, siguria e jetës dhe e pronës ka të bëjë me garantimin e pacenimit apo mosrrezikimit të tyre nga agjentë të tjerë si p.sh. zjarret.

Nëse shkon në Danimarkë dhe viziton Kopenhagënin nuk ka si të ndodhi që të të mos t'u tregojnë se disa shekuj më parë qyteti u dogj. Tragjedia ishte shumë e rëndë. Nisi në 20 tetor 1728 dhe u fik më 23 tetor. Njerëzit pësuan dëme të pallogaritshme, por kur flakët u shuan dhe hiri u ftoh edhe mendjet e tyre gjetën paqen dhe reflektuan. Pyetja pezull ishte: Ç'duhet bërë që mos ndodhi më kjo tragjedi? Por edhe nëse ndodh si duhet t'i rivëmë në vend humbjet e shkaktuara? Për të gjetur sigurinë ata ndërtuan një sistem të sigurimeve që nga koha në kohë u përmirësua dhe është ende në sistemin danez të sigurimit nga zjarri. Qytetet rrezikohen nga përmbytjet. Kur kujtojmë katastrofa të tilla sjellim ndërmendje pamje të frikshme jo të kohëve të shkuara, por edhe të ditëve tona kudo në botë.

Shirat e rrëmbyeshëm në kushtet e ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike janë bërë fenomen i kudotakuar në mbarë rruzullin tokësor. Mbrojtja nga një fenomen i tillë kërkon strategji mjete të specializuara dhe burime njerëzore gjithë po aq. Lypen skenare mbrojtëse. Përmbytet Amerika mund të thuhet pa një pa dy. Në rregull ashtu është. Por ne duhet të shohim se përmbytet Shkodra vit për vit, përmbytet Fieri, Lushnja, Vlora etj. Dëmtohen shtëpi, ka humbje në prodhime bujqësore dhe në gjënë e gjallë. Ndaj fakti që përmbytjet përsëriten nuk japin gjasa të mbyllësh sytë, të kujtohesh kur ndodh apo më keq akoma të harrosh dhe të vijosh me një parodi mbulimesh me fonde nga buxheti i shtetit i dëmeve.

Kështu fonde, të cilët përdoren për emergjenca civile zvogëlojnë fondet e investimeve publike për shkolla, qendra shëndetësore, spitale, rrugë, ujësjellës apo sisteme të qëndrueshme të largimit dhe defekalizimit të ujërave të zeza. Qyteti mund të rrezikohet nga fenomene si tërmeti apo vullkanet. Fenomene të tilla vërtetë nuk mund të parandalohen, veç se sistemet e mbikëqyrjes së lëvizjeve sizmike duhet që në mënyrë të pandërprerë të vigjilojnë dhe të paralajmërojnë. Gjithashtu, banesat e ndërtuara rishtazi të kenë që në projekte pasaportë garancie se deri në sa ballë lëvizje sizmike përballojnë. Të mos lejohet të ndërtohet në shtresa tokësore të pastudiuara dhe pa lejen antisizmike ose me keq akoma me leje të blerë nëndorë. Lënda e parë që përdoret si çimento dhe hekuri duhen kontrolluar me



rigorozitet atje ku prodhohen, por edhe atje ku importohen. Si dhe sa hidhen në konstruksion, a zbatohet protokolli manual. Tragjedia e urës 'Morandi' shkundi Europën.

Gjithçka mund të thuhet dhe stërthuhet tani post tragjedi, por kudo takohet shqetësimi për abuzime në ndërtime dhe në mbikëqyrjet e riparimet korente. Politikat koncesionare që ushqejnë dhe majmin nga korrupsioni e vjedhjet, koncesionarin për vete, por edhe koncesiondhënësit. Vite më parë në Seul(21 tetor 1994) u shemb një urë. Kryetari Bashkisë që nuk kishte shumë kohë që ishte zgjedhur dha menjëherë dorëheqjen pa çka se ai nuk kishte përgjegjësi direkte për atë ndërtim. Në Tiranë para disa vitesh mbeti hapur dera e shkarkimit në digën e liqenit artificial. Mbledhësi(kolektori) ishte bllokuar nga një ndërtim që ishte bërë mbi të. Për pasojë u përmbyt pjesa veriperëndimore e qytetit më dëme të ndjeshme në banesa dhe në biznese. Askush nuk dha dorëheqjen dhe askush nuk u ndoq penalisht. Së fundmi me vendim gjykate jepet leja për ndërtim shumëkatësh në buzë të digës së liqenit artificial. Mbetet të shohim post-historinë. Basene të tilla si rezervuare ka me dhjetëra në të gjithë territorin e vendit si edhe diga, ndërtime këto tejet të studiuara shkencërisht që disiplinonin prurjet ujore nga malet dhe më tej vijonin në një rrjet kanalesh primare e dytësore, në mbledhës të vegjël në sisteme kulluese e deri në kanalizime të cektë për drenazhim tokash.

Ky ansambël disiplinues i ujërave që dha fond toke dhe mënjanoi moçalimin e saj është tashmë pothuaj jashtë funksionimit. Territore të tëra rurale nënurbane dhe urbane janë të rrezikuar si të mbetur në mëshirën e fatit. Pas reformës territoriale dhe administrative, shumë prej këtyre zonave janë përfshirë në juridiksionin e Bashkive dhe u takojnë qyteteve. Me dy fjalë të shkoqura, siç thotë populli, me shtetin me ujin dhe me zjarrin mos luaj. Në vitet e tranzicionit ky mësim jete ka marrë trajtën me shtetin që nuk është më me ty qytetar mos u merr. Ai luan me ty duke të lënë në mëshirën e zjarrit dhe të ujit. Po ra zjarri lutu nga qielli se zjarrfikëset janë me pakicë, niveli i tyre në shumë qytete le shumë për të dëshiruar. Ende nuk dëgjojmë që në buxhetin e shtetit të ketë një zë shpenzimesh për rigjallimin e fondit të tyre fizik. Shqipëria digjet çdo vit. Zjarrfikësit rrezikojnë jetën, mjetet nuk shtohen.

Në një vend ku (keq)shpenzohen fondet publike për shtetarët që makinat e tyre apo zyrat të jenë sa më moderne dhe ku mjetet e emergjencës për shërbime ndaj publikut të jenë si mos më keq, e pakta ky vend nuk është social. Para disa viteve ra dëborë e madhe. Tetë orë në një kovë mjeti gërmues (ekskavator) një grua shtatzënë u lëviz nga një zonë e bllokuar deri në rrugën ku shkonin automjetet. Kur shikoje pamjet nga televizioni nuk doje të besoje se si një vend i NATO-s nuk ka makina me slita që përdoren në dëborë apo shërbim ambulator me helikopter sanitar me slita. Qyteti është i rrezikuar nga patologjitë e kufizuara në disa zona ose kur ato shndërrohen në rreziqe masive që kërcënojnë popullatën e gjerë(endemike dhe pandemike). Shkaqet janë të ndryshme si p.sh. cilësia e ujit të pijshëm, ndotjet nga mbetjet urbane dhe helmimi i ajrit nga djegia e tyre në qiell të hapur. Rrezikojnë ngarkesat e larta bakteriale, infeksionet virale që janë të pakontrolluara. Spitalet publike të prapambetura që lënë për të dëshiruar nga higjiena dhe që janë larg cilësisë së mjekësisë moderne instrumentale, që kanë gjendje laboratorike mjerane dhe staf që bjerret dita-ditës nga ikja e specialistëve jashtë vendit. Qyteti është i rrezikuar kur nuk ka furra speciale për eliminimin e mbetjeve spitalore.

Qyteti është në tehun e briskut nëse nga organe të specializuara nuk sigurohet garancia ushqimore. Këtë stinë të nxehtë më në fund AKU( Autoriteti Kombëtar i Ushqimit) u bë i gjallë, doli në terren dhe hapi sytë që të bënte detyrën. Gjetje skandaloze( lexo në mënyrë metaforike skandal...pra nuk ndalen që vetëm të fitojnë pa çka se e vrasin shëndetin publik në qytet dhe më gjerë kur është fjala për zonat turistike). Qytetet janë të rrezikuara nga lëvizjet kaotike kur nuk ka studime shkencore për lëvizjen e mjeteve dhe këmbësorëve, për parkimin e tyre dhe për korsitë e emergjencave. Puna që po bëhet në qytetin e Tiranës ngjall besim dhe optimizëm, por ajo duhet të bazohet në një studim ku duhet menduar fluksi i lëvizjeve, demografia brenda dhe jashtëqytetase, lidhjet urbane, oraret e pikut dhe ndryshimi pa dyshim i kahjeve të lëvizjes sipas motit dhe stinëve. Nëse sheshi "Skënderbej" në qendër të Tiranës ka gjallëruar jetën qytetare dhe atë të argëtimit, por njëherësh është bashkëshoqëruar me prishjen e gjithë qarkullimit të makinave rreth tij dhe si pasojë edhe në rrjete e mëtejshme; e gjitha kjo gjendje ka kosto dhe tregon se llogaritjet nuk janë realizuar të plota. Nëse qyteti i Tiranës ka shkuar në një milion banorë dhe gjatë ditës hyjnë e dalin me qindra mijëra të tjerë dhe qyteti ka një hyrje në veriperëndim dhe një në juglindje pa hyrje-dalje alternative, rreziku i aksidenteve është prezent, jo pikërisht atje, por ndoshta më tej, nga ata që ngasin makinat në kërkim të kohës së humbur dhe fatalisht gjejnë aksidentet shpesh me pasoja humbje jete.

Rreziku në qytete është edhe çështje kulture. Shpesh për të mos thënë gjithmonë këmbësorët në Tiranë ecin më keq se bagëtitë në qytete të vegjël apo rrugë nacionale. E ka pesë metra afër vendin e vijave të bardha dhe i del përpara automjetit që sapo i hapet drita jeshile e semaforit kërkon të lëvizi sepse e godet makina nga pas. Në autostrada ka edhe të marrë kokë e këmbë, sepse shohin sa larg është makina dhe o burra hidhen të kalojnë nga njëra anë në tjetrën. Urat mbikaluese janë, por nuk përdoren, ndërsa në hyrje të autostradës Tiranë-Durrës te sheshi 'Shqiponja', sa bën të hysh duhet të ndalesh se lëvizin njerëz mbi vijat e bardha. Pikërisht ku duhet ura mbikaluese këtu ajo mungon. Tek korsia e biçikletave e kanë gjetur rehat, tani lëvizin motoçikletat-taksi që ndajnë picat dhe policët nuk i ndalin. Siguria është edhe LIRI. Ndokush mund të habitet. Le ta analizojmë më në hollësi. Nëse nuk je i sigurt për jetën t'i ngushton gjeografinë e lëvizjes. Nuk shkon në zonat e nxehta, nuk shkon në restorante apo lokale ku plas sherri dhe shkrepet koburja. Ti si qytetar nuk del natën vonë, sepse s'je i sigurt. Nuk kalon në zona të ndriçuara keq ose të pandriçuara fare. Nëse krimi organizuar kontrollon territorin e qytetit tënd ti nuk ke liri, sepse krim i organizuar do të thotë që ai të bashkëpunojë dhe të kontrollojë disa nga institucionet më të rëndësishme si policinë, bankat, kufirin, zyrat e tatimeve, pushtetin lokal, spitalet e kirurgjisë, burgjet dhe paraburgimin.

Kohët e fundit qarkullon në internet një material në lidhje me gjendjen e rendit civil në disa qytete kryesore të vendit. Pa dashur të besoj verbazi ajo që shqetëson qytetarin është heshtja e policisë së paku për përgënjeshtrim. Ministri Brendshëm u shpreh në Elbasan para disa muajsh në një takim me qytetarët *se "policia do ua nxijë jetën grupeve kriminale."* Me këtë ai pohoi prezencën e tyre, se ata deri tani ua kishin nxirë jetën qytetarëve dhe se policia është gati të ndeshet me krimin. Kaluan disa muaj, por asgjë nuk është dëgjuar për nxirjen apo zbardhjen e gjendjes dhe realitetit. Një zbythje e tillë tregoi se krimi është më i fortë se organet e specializuara. Heshtja institucionale llogaritet. Njerëzit dinë të lexojnë dhe bëjnë aritmetikë sociale. Tani dëgjuam se në shtator tetor do goditen grupet kriminale. Profesionalisht një deklarim i tillë është i gabuar. I thua kriminelit bëju gati ose ik! Kujdes me lirinë ajo nuk është si edhe duket. Liria si lëvizje, si pronë, si prosperitet është e pagarantuar në një pjesë të madhe të territorit të vendit. Prej vitesh flitet për punën e policisë në/ dhe me komunitet, por gjendja flet për arritje jo të qenësishme.

Ndodh që ose krimi (deri me marrje jete) i gjen të gjitha palët gafil, ose policia ka dijeni dhe nuk ka predispozitën, nuk ka mjetet apo besueshmëri brenda vetvetes. Ka policim të spiunuar. Më keq akoma drejtues policie merren me veprime kriminale si edhe ishte rasti i kultivimit të kanabisit. Shkon SHKB-ja t'i arrestojë dhe ata marrin arratinë të (para)lajmëruar. A thua se ishin miza që fluturuan për të kaluar kufirin. Ndërtohet pistë për ulje avionësh sportiv që transportonin kanabis dhe askush nuk e sheh, madje as policia e rendit që e ka për detyrë kontrollimin e territorit. Ose më keq akoma e sheh, por i thonë: pe? Jo, nuk pashë! Dëgjove? Jo, nuk dëgjova! Ai që flet me kurajë largohet nga puna ose nga jeta. Siguria lidhet dhe me gjykatat. Më kujtohet një film amerikan. Për shkak të një vepre penale gjyqtari dha dënim maksimal. Kur procesi mbaroi e pyetën: "Pse ishe aq radikal." Përgjigjja e tij qe lakonike. Për t'iu siguruar jetën qytetarëve të tjerë që janë gjallë. Nëse gjykatat tek ne nuk e ndëshkojnë krimin penal ata janë bashkëpunëtorë jo thjesht dhe se marrin ryshfet, por janë gjenerues të krimit për dy arsye themelore. Kriminelì del nga burgu dhe është i lirë, dhe së dyti krimi nuk është i trembur se është më i fortë se ligji. Edhe vendimmarrja politike në të gjitha nivelet ka të bëjë me sigurinë. Nëse shkelet ligji për prokurimet publike dhe ai që ka bërë burg për krim penal bëhet biznesmen i suksesshëm me fonde publike, kjo lloj vendimmarrje shëndosh monetarisht krimin qoftë dhe në mundësi përsëritje, prish klimin qytetare dhe e shpien nivelin e sigurisë në tregues tejet tejet të ulët. Liria është jo thjesht fjala e lirë, por është edhe lëvizja e lirë, jeta e garantuar, prona e pacenueshme, zhvillimi dhe investimi i garantuar, jeta publike e qetë dhe në begatinë e lidhjeve gjithë shoqërore dhe antropologjike. Sulmet edhe ndaj turistëve të huaj për grabitje dhe përdhunime dëshmojnë sa më lart pohojmë. Janë vërtet raste të izoluara, por ato duhen shmangur. Gjithkush që vendos të udhëtojë diku, fjala vjen në Marok, apo në Brazil, në Shqipëri apo në Bosnje pyet dhe do që të garantohet, a janë vende të sigurta? Pas kësaj parashtese të gjatë, sërisht kemi arsye dhe argumente të shtrojmë pyetjen. Çfarë do të thotë qytet i sigurt?!

Krimi... siguria... perceptimi...

Në një studim në lidhje me sigurinë në metrotë e SHBA-ve, evidentohen një sërë faktorësh që duhen konsideruar. Mes tyre është raporti mes krimit-sigurisë-perceptimit dhe studimeve socio-psikologjike të adresuara, si dhe roli i qendrave të specializuara për studime adresuar te këto problematika.

Pse njerëzit ndihen më të sigurt në disa qytete sesa të tjerët? A është një funksion i krimit aktual apo i faktorëve të tjerë që formojnë mënyrën se si i perceptojmë qytetet? Krimi, sidomos krimi i dhunshëm, ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha qytetet e SHBA-ve dhe në zonat e metrosë si dhe brenda tyre. Le të lexojmë në kushtet e vendit tonë ku nuk ka metro, si është perceptimi ndaj krimit dhe sigurisë në stacione treni apo parqe të autobusëve ndërurbanë, në aeroport apo në stadiume; pra në hapësira ku ka mbipopullime me njerëz që nuk e njohin njëri-tjetrin dhe nuk janë anëtarë të një komuniteti homogjen. Një sërë studimesh sugjerojnë se perceptimet e sigurisë janë të kushtëzuara nga faktorë të tjerë të dukshëm dhe më pak të dukshëm që sinjalizojnë në mënyrë efektive sigurinë e komunitetit.

Teoria famëkeqe e "thyerjeve të dritareve" të përshkruar nga James Q. Wilson dhe George L. Kelling (në një botim të vitit 1982 ) sugjeron një lidhje të ngushtë midis kushteve të lagjes dhe krimit aktual si dhe perceptimeve të tij. "Psikologët dhe policët socialë priren të pranojnë se, nëse një dritare në një ndërtesë është thyer dhe është lënë pa u riparuar, të gjitha pjesët e tjera të dritareve së shpejti do të thyhen. "Kjo shenjë është po aq e vërtetë në lagjet e bukura sa në ato të rrënuara." - shkruanin ata. Tek ne u dha shenja në godinën e Prokurorisë së Durrësit por askush nuk lëvizi deri sa pas disa ditësh u grabit zyra e prokurorit. Një studim

i kohëve të fundit nga Organizata Gallup ofron një matës krahasues të perceptimeve rezidente për sigurinë në të gjithë metrotë e mëdha të SHBA-ve. Bazuar në të dhënat nga studimi i Gallup-Healthëays Well-Being Index, janë vlerësuar përqindjet e banorëve, të cilët thonë se "ndihen të sigurt" duke ecur vetëm natën në 50 zonat më të mëdha të metrove të Amerikës. Një studim i tillë duhet ndërtuar edhe në qytet e Shqipërisë. Jemi para zgjedhjeve lokale, ndaj kjo pyetje e qytetarëve do ishte me vend. Zoti kandidati i mundshëm për kryetar bashkie sa i sigurt është qyteti ynë, a keni ju ndonjë studim? Unë si qytetar po ju pyes:

1-Cila është lidhja midis sigurisë së perceptuar dhe krimit aktual?

*2-Cilët janë faktorët përveç krimit që mund të veprojë në perceptimin e sigurisë? A ka* studime që hedhin dritë dhe ofrojnë besueshmëri se cila është ndërlidhja statistikore ndërmjet masës së sigurisë dhe masave të ndryshme kundër krimit, si dhe kushteve sociale, demografike dhe ekonomike të hapësirës qytetase?! *Duhet të mbajmë në vëmendje se korrelacioni nuk nënkupton vetëm shkakun, por vë në dukje lidhjet ndërmjet variabëlve. Raportet krim-(pa)siguri janë në proporcion të drejtë.* Sa më shumë krim aq më shumë pasiguri edhe si perceptim. Por perceptimi lyp target grup në zonën e krimit dhe jo dokudo dhe sigurisht strukturë antropologjike duke mbajtur në qendërshikim arsimimin e të pyeturve. Perceptimi duhet krahasuar me të dhënat zyrtare që të shihet a ka përputhje apo jo. Modeli amerikan i lartpërmendur ka nënvizuar se: "*Perceptimet e sigurisë, gjithashtu, përmbysen nga nivelet e arsimit të të anketuarve. Korrelacioni mes sigurisë së perceptuar dhe nivelit arsimor (e matur si përqindja e të rriturve që janë të diplomuar në kolegj) është ndër më të lartat në analizën e vet. "Gjithashtu, po ky model pohon bazuar në studimin e perceptimit se: "Struktura e ekonomisë lokale dhe e tregut të punës, gjithashtu, luan një rol.* Ekziston një korrelacion thelbësor midis sigurisë së perceptuar dhe pjesës së punëtorëve në punët e ekonomisë dhe ata në fushën e dijes." Unë ngre shqetësimin se te ne në Shqipëri nuk ka studime në vijueshmëri dhe të dhëna serioze të regjistruara.

Në realitetin tonë ose gjen deklarata në emisione lajmesh nga ndonjë kasnec ose gjen më shumicë OJF që rrjepin fonde dhe hanë dreka në hotele luksoze pasi zhvillojnë me demek ato aktivitet e famshme me slide dhe me dokumente ku qëllimi është justifikimi shpenzimeve që janë goxha të majme por pa ndonjë rezultat pozitiv konkret. Në kësi punimesh duhet të hynë universitet dhe njerëz me integritet dhe studiues serioz. Krimi te ne bën kërdinë perceptimi spontan shpreh shqetësim, studimet e mirëfillta nuk janë të pranishme. Ky është indirekt pajtim me gjendjen që ndryshe mund të lexohet me krimin si nënshtrim dhe pafuqi civile për të reaguar. Studiuesit amerikanë nënvizojnë "*se siguria e perceptuar është më e ulët te individët e klasës punëtore. "Me sa duket puna e rëndë dhe jeta e vakët sociale i bën ata më pak të interesuar dhe pak të dëshiruar për lirinë. Ndërsa mëtojnë ata: "Artistët dhe krijuesit kulturorë për një kohë të gjatë, janë perceptuar si shënues të rivitalizimit urban: Ekziston, gjithashtu, një korrelacion pozitiv midis pjesës së punëtorëve në punë artistike dhe kreative dhe sigurisë së perceptuar, megjithëse kjo mund të reflektojë pasurinë e përgjithshme të një vendi, gjithashtu".* Shpjegimi është i qartë jeta artistike e ushqen lirinë ashtu dhe puna e karakterit të tillë.

Krimi e kufizon lirinë ndaj perceptimi për gjendjen është i gjallë dhe i përgjegjshëm. "Në anën e rrokullisjes dhe jo çuditërisht, ndjenja e pasigurtë është e lidhur ngushtë me racën dhe varfërinë"- ka konkluduar studimi i studiuesve amerikanë. Tek ne lexoje endacakët dhe romët, njerëzit që jetojnë në periferi si brigjet e lumenjve apo landfillet. Perceptimet rezidente të sigurisë në të gjithë qendrat ku gulon lëvizja(në Amerikë metrotë) janë të lidhura negativisht me pjesën e popullsisë që nuk është e bardhë, me përqindja e banorëve nën kufirin e varfërisë dhe norma e papunësisë.

Siguria e perceptuar është, gjithashtu, e lidhur negativisht me mungesën e strehimit që përputhje me të dyja shpjegimet e varfërisë dhe me teorinë e dritareve të thyera.

Është sugjeruar zakonisht që njerëzit janë më të shqetësuar dhe të frikësuar në qytetet më të mëdha. Por analizat studimore nuk gjejnë asnjë lidhje statistikore midis dendësisë së popullsisë dhe krimit ashtu dhe madhësisë së qyteteve popullsisë dhe krimit në një lidhje shkak pasojë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, ka të ngjarë që densiteti do të luante një rol më të madh në perceptimet e sigurisë në të gjithë lagjet urbane kundrejt lagjeve periferike. *Supozohet, gjithashtu, se pronësia në shtëpi u jep njerëzve një rol më të madh në komunitete, duke nxitur një kohezion më të madh shoqëror dhe duke rritur ndjenjën e sigurisë.* Por analiza e studiuesve amerikanë nuk gjen asnjë lidhje statistikore midis sigurisë së perceptuar dhe pjesës së popullsisë që jep shtëpi me qira. Ndërsa kjo gjetje mund të ndryshojë nëse përfshihen metropolet më të vogla, ose nëse analiza u zgjerua në nivelin e lagjes, përsëri vlen të përmendet se ekziston një ndryshim i konsiderueshëm në kostot e marrjes me qira dhe të strehimit përgjatë zonave ku ka dendësi të lëvizjes së njerëzve(rasti 50 metrove në Amerikë) Feja konsiderohet të jetë një faktor kyç në kapitalin social dhe kohezionin e popullatës.



Konservatorët socialë do të shtonin se feja është një shenjë e strukturës morale të një komuniteti. Kështu do të prisnin që njerëzit të ndiheshin më të sigurt në bashkësitë fetare. Por ky nuk është rasti në nivelin e metrosë, sipas analizës së studimit Mellander. Në fakt, pjesa e popullsisë që identifikohet si shumë fetare është e lidhur negativisht me sigurinë e perceptuar në nivelin e metrosë. Klima gjithashtu luan një rol, sipas analizës së Mellander. Perceptimet e sigurisë janë gjithashtu të lidhura negativisht me temperaturat mesatare të larta në janar (-57) dhe korrik (+38). Me fjalë të tjera, metrotë më të ngrohta përgjithësisht perceptohen si më pak të sigurta. Konkluzion... në studimin e kolegëve amerikanë që janë marrë me studimin e sigurisë në 50 metrotë e USA, njerëzit ndihen më pak të sigurt kanë: *Shkallë më të lartë varfërie, shkallë më të lartë papunësie, nivele më të larta si të pastrehë, përqindje më të larta të popullsisë që nuk janë të bardhë, nivele më të ulëta të arsimit (të matur si përqindja e të rriturve që janë graduar në kolegje), më shumë struktura ekonomike në klasë të punës dhe nivele më të larta të religjionit. Metrotë ku njerëzit ndihen më të sigurtë kanë: Nivele më të larta të të ardhurave dhe arsimimit, më pak papunësi, më pak të pastrehë dhe më shumë struktura ekonomike dhe kreative të bazuara në njohuri. Kur thuhet dhe bëhet gjithçka, perceptimi i sigurisë duhet të pasqyrojë begatinë, nivelet e arsimit dhe rrethanat ekonomike të vendeve të paktën po aq, ose ndoshta më shumë, sesa realiteti themelor i krimit.* Richard Florida është bashkë-themelues dhe redaktor i CityLab dhe një redaktor i lartë në Atlantik. Ai është profesor universiteti në Shkollën e Menaxhimit të Shkollës së qyteteve të Universitetit të Torontos dhe Rotman, dhe një shok i shquar në Institutin Schack të Real Estate të Universitetit të Nju Jorkut. Çfarë do të thotë për të të ndihesh i sigurt në qytet...?!"*Kur mendojmë për fjalën "siguri", çdo gjë mund të vijë në mendje. Ndoshta është diçka e thjeshtë sa mbyllja e dyerve gjatë natës, ose mundësia që të mbani diçka për ju personalisht për të mbrojtur veten. Sido që të jetë, ne e shohim atë, "siguria" është vendimtare pa marrë parasysh se çfarë bëni ju ose kush jeni rreth pjesës më të madhe të ditës tuaj. Unë mendoj se ne të gjithë mund të bien dakord për një gjë, edhe pse: Të ndiheni të sigurt derisa jemi në shtëpi është shumë e rëndësishme në skemën e madhe të gjërave.* "Disa njerëz ndihen krejtësisht të sigurtë vetëm me mbylljen e dyerve të tyre gjatë natës, e cila është plotësisht e mirë, por kjo nuk mjafton.

Në SHBA, FBI vlerësoi se gjatë vitit të kaluar kishte më shumë se 2,000,000 vjedhje me 66% të atyre të varieteteve rezidenciale aq të mjaftueshme për të thënë se ka shumë punë për të bërë. *Sistemet e sigurisë në shtëpi janë një mjet i dobishëm për të penguar dikë që të hyjë në shtëpinë tuaj nëse jeni atje ose jo.* Ato mund t'ju kursejnë mijëra dollarë në krahasim me alternativën e shtëpisë tuaj të thyer, si dhe t'ju japin juve dhe të dashurve tuaj një pjesë të mendjes duke e ditur se shtëpia juaj është në duar të mira nëse jeni në shtëpi ose në pushime. A ËSHTË E MIRË KJO MASË?

*Një sondazh i kohëve të fundi në SHBA i 422 vjedhësve të dënuar tregoi se 83% e tyre do të përpiqeshin të kuptonin nëse në një shtëpi kishte një sistem sigurie para se të merrnin në shqyrtim edhe tentimin për vjedhje, me gjysmën e pranimit se ata as nuk do të tentonin të hynin.* Sistemet e sigurimit në shtëpi mund të shkojnë nga 600 deri në 1200 dollarë, por kostoja mesatare e vjedhjeve mund të jetë mbi $ 5,000 deri në 20,000 dollarë, kështu që ia vlen të sigurohet shtëpia juaj kur të keni mundësi. Në fund të ditës, zgjedhja duket shumë e thjeshtë dhe nëse doni nivel shtesë të rehatisë merrni sistemin e sigurisë në shtëpi që i përshtatet të gjitha nevojave tuaja.

* * *

*Roli teknologjisë për një qytet të sigurt...Si mundet teknologjia t'u përgjigjet sfidave të sigurisë në qytete?!* Teknologjia mund të luajë një rol të rëndësishëm në ndihmë të qyteteve për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë. Po sjell një manual, i cili përshkruan shtatë fusha të rëndësishme të sigurisë ku qytetet mund të përdorin teknologjinë në avantazhin e tyre: 1-Sistemet biometrike të identifikimit, të cilat kanë potencial për të reduktuar gabimin njerëzor dhe kohën e përpunimit dhe do të rrisin shërbimet ndaj qytetarëve dhe kontrollin e imigracionit. 2-Sistemet e njohjes së fytyrës dhe teknologjitë e tjera parashikuese do të zhvendosin zbatimin e ligjit nga reaktive në proaktive. 3-Sistemet e automatizuara të mbikëqyrjes do të reduktojnë varësinë nga puna e njeriut dhe do të sigurojnë monitorimin e infrastrukturës kritike, si p.sh. shërbimet e energjisë, ujit dhe telekomunikacionit. 4-Masat elektronike të sigurisë do të mbrojnë shërbimet e ndjeshme të administratës publike nga rreziqet virtuale, ndërsa mjetet analitike të të dhënave mund të parashikojnë shpërthime të sëmundjeve. 5-Menaxhimi i fortë i informacionit, nëpërmjet masave të zgjeruara të sigurisë dhe skemave të mbrojtjes së të dhënave, do të ndihmojë institucionet dhe korporatat të mbrohen nga sulmet kibernetike.6-Sistemet që integrojnë informacionin, analizojnë të dhënat dhe komunikojnë me përgjegjësit e parë dhe publiku do t'i ndihmojë qeveritë të reagojnë ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.7-Platformat teknologjike do të lehtësojnë bashkëpunimin e efektshëm midis degëve të ndryshme të qeverisë, duke rritur bashkëpunimin midis agjencive.

Siguria në qytet për fëmijët—ecja në rrugë dhe shenjat, edukimi dhe siguria...

Duke studiuar një projekt shkollor sociologjik takova këtë slogan: "*Kthejeni fuqinë në dritat e rrugëve dhe sinjalet e këmbësorëve në Qytetin e Sigurisë". Ky aktivitet është një ndihmë mbi stërvitjen e projektuar për të mësuar fëmijët se si të aktivizojnë pajisjet e kontrollit të trafikut për kalime të sigurta në rrugë dhe t'i ndihmojnë ata të interpretojnë simbolet dhe mesazhet e pajisjes së kontrollit të trafikut.* Fëmijët do t'i kryejnë këto detyra në kryqëzimin e qytetit të sigurisë, pasi mësimi i Kalimit të Rrugës të përfundojë në klasë. *Është shumë e rëndësishme që fëmijët e vegjël të kuptojnë se NUK duhet të përpiqen të kalojnë në rrugë pa një të rritur.* Fëmijët do të mblidhen jashtë në një nga qoshet e kryqëzimit të Qytetit të Sigurisë. Ata do të praktikojnë aktivizimin e pajisjeve të kontrollit të trafikut, dhe kalimin e rrugës në mënyrë të sigurtë në kryqëzimet e pikturuar. Si realizohet?!

*Menjëherë pas mësimit në klasë fillon praktika: "Të jesh i mençur në rrugë", që do të mbulojë bazat e kalimit të rrugëve dhe sinjaleve të kontrollit të trafikut. Ky aktivitet do të forcojë më tej njohuritë dhe aftësitë e fëmijës në sjelljen e sigurt të kalimit të rrugëve dhe do të shërbejnë si një rishikim i frytshëm. Kryqëzimi i Qytetit të Sigurisë do të përdoret ekskluzivisht për këtë aktivitet.* Drejtoni vëmendjen e fëmijëve në sinjalet "Ecni" dhe "Mos ecni", dhe në dritën e trafikut të varur nga mesi i kryqëzimit. Shqyrto se çfarë përdoren këto sinjale dhe si mund ta bëjnë të sigurt për ta që të kalojnë në rrugë. Ndërsa dritat ndryshojnë, pyetni nëse është e sigurt apo e pasigurt për të kaluar në rrugë.(kështu duhet të jenë dhe semaforët te ne dhe jo thjesht me drita e kuqe jeshile e verdhë.)Shqyrtoni procedurën e duhur për kalimin e rrugës. Theksoni se edhe nëse sinjali është ndalimi i trafikut, ata duhet të vazhdojnë me kujdes dhe të kërkojnë në të majtë, djathtas dhe majtas ndërsa kalojnë në kryqëzim.

Ndërsa sinjali ndryshon nga "Mos ecni" në "Ecni", merrni fëmijët nëpër rrugë. Nga rruga ku ka rënë zjarri kaloni çdo rrugë duke lëvizur në drejtim të kundërt dhe duke përfunduar në rrugën e sigurtë. Diskutimi parësor gjatë këtij aktiviteti duhet të fokusohet në: Dallimi nga fëmija i shenjave "Ecni", "Nuk ecni" dhe simboleve të tjera. Çfarë do të thotë nëse po ndizet? Çfarë do të thotë nëse është e qëndrueshme? Si mund ta aktivizojnë pajisjen nëse nuk është automatike? Rëndësia e kërkimit. Pse është e rëndësishme të vazhdosh kërkimin e majtë, e djathtë? Kalimi në kryqëzim. Cili është qëllimi i tij? Pse është pikturuar nëpër rrugë? Çfarë i thotë një motoristi që i afrohet kryqëzimit? Ky tip aktivitet është hartuar për të ri-theksuar fëmijës rëndësinë e mësimit "Të jetë i mençur në rrugë" dhe t'u japë atyre ndihmë në praktikën e kalimit në rrugë i sigurt në kryqëzimin e Qytetit të Sigurisë. Përveç kësaj, fëmijët do të shtojnë njohuritë e tyre për identifikimin dhe përdorimin e pajisjes së kontrollit të trafikut.

## HOROSKOPI

### DASHI

Shëndeti mbetet i mirë. Eksploroni mundësi të reja investimesh që vijnë sot, por angazhoni veten vetëm pasi të keni studiuar qëndrueshmërinë e këtyre projekteve.

### DEMI

Sot do të merrni një surprizë të bukur nga partneri juaj. Dita do të sjellë aromën e trëndafilave rreth jush. Gëzoni ekstazën e dashurisë që ofron fati. Gjërat duken bukur edhe në punë.

### BINJAKET

Kohët e fundit jeta juaj personale ka qenë fokusi i vëmendjes së disa personave të cilët nuk janë miqtë tuaj më të mirë. Problemet në pritje duhet të zgjidhen së shpejti dhe ju e dini se duhet të filloni diku, fillimisht duke menduar pozitivisht.

### GAFORJA

Parashikohet një ditë e lodhshme dhe stresuese në punë. Më shumë ju lodh energjia negative që përcjellin persona të caktuar. Mënyra më e mirë është që t'i shmangni këta persona.

### LUANI

Mos e humbni qetësinë edhe nëse përballeni me kundërshtime në familje.
Kontrolloni sjelljen tuaj të nxituar, pasi ajo mund të shkatërrojë një miqësi të mirë. Disa prej jush mund të ndërmarrin një udhëtim të largët që mund të jetë plot tension.

### VIRGJERESHA

Kjo është një ditë e mrekullueshme për të negociuar me klientë të rinj. Personaliteti i juaj magnetik do t'ju vërë në qendër të vëmendjes. Shmangni dietën me kalori të larta dhe rrisni nivelin e ushtrimeve dhe stërvitjes.

### PESHORJA

Sot ju ndiheni të relaksuar dhe në humor të duhur për të shijuar ditën. Investimet janë të rekomanduara, por kërkoni këshilla të përshtatshme. Sot do të jeni në qendër të vëmendjes dhe suksesi është i parashikuar.

### AKREPI

Kontrolloni natyrën tuaj impulsive pasi ajo mund të shkatërrojë disa marrëdhënie të mira. Kushtojani kohën dhe energjinë tuaj për të ndihmuar të tjerët, por mos merrni pjesë në çështje që nuk kanë lidhje me ju.

### SHIGJETARI

Mos lejoni që krenaria të bëhet pengese për suksesin tuaj. Njerëzit e suksesshëm kanë kaluar nëpër sfida të paimagjinueshme. Një lidhje dashurie është e favorizuar.

### BRICJAPI

Kontrolloni gjuhën dhe tonin e zërit në një aferë dashurie pasi mund t'ju hapë shumë probleme. Ne çështjet financiare nuk jeni shumë i favorizuar për momentin, por faza e vështirë do të jetë kalimtare.

### UJORI

Duhet të kontrolloni emocionet dhe të hiqni qafe frikën sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi shanset për të ndikuar menjëherë në shëndetin tuaj janë të shumta.

### PESHQIT

Shëndeti juaj ka nevojë për shumë kujdes. Mos prisni që gjërat të ndodhin, por dilni dhe kërkoni për mundësi të reja. Nëse planifikoni udhëtime, sigurohuni që të mbani të gjitha dokumentet e rëndësishme me vete.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al


Universiteti Europian i Tiranës
maiora premunt / gjëra të mëdha na presin
TRANSFEROHU NË UET
MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR
DATA 03-13 Shtator 2018
• Juridik i Përgjithshëm
• Financë & Bankë
• Menaxhim Biznesi
• Informatikë Ekonomike
• Shkenca Politike
• Marrëdhënie Ndërkombëtare
• Psikologji
• Sociologji – Antropologji Sociale
• Komunikim – Marrëdhënie Publike
• Komunikim Dizajn
Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare